

**ROLI I INSTITUCIONEVE DHE I MËSUESVE
PËR TË KRIJUAR PARTNERITET
NË MBËSHTETJE TË PRINDËRVE
NË ZHVILLIMIN TËRËSOR TË FËMIJËVE**



Gendra Burimore për Mirëqenien
e Fëmijëve dhe Familjes



Save the Children



Botimi i këtij dokumenti u mundësua nga Save the Children.

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne punojmë në 120 vende të botës. Ne mbrojmë jetën e fëmijëve; luftojmë për të drejtat e tyre dhe i ndihmojmë ata të përmbushin potencialin e tyre.

TIRANË, 2014

Ky botim publikohet në kuadër të projektit "Mbështetje teknike në përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit" financuar nga Save the Children Norvegji (SCN), në bashkëpunim me Qendrën Burimore për Mirëqënien e Fëmijëve dhe Familjes.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve për zhvillim politikash dhe praktikash, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatës Save the Children si burim.



Gendra Burimore për Mirëqenien
e Fëmijëve dhe Familjes



Save the Children



ROLI I INSTITUCIONEVE DHE I MËSUESVE PËR TË KRIJUAR PARTNERITET NË MBËSHTETJE TË PRINDËRVE NË ZHVILLIMIN TËRËSOR TË FËMIJËVE

Autorët:

Dr. Izela Tahsini

Dr. Veronika Duci

Dr. Kristina Voko

Mbështeti:

Ema Kasapi, Save the children

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1 Seancë: Njohja me programin e trajnimit	3
Prezantimi dhe njohja me programin e trajnimit	3
Ushtrim: Vendorsja e rregullave	4
Ushtrim: Të njihemi më mirë	5
Ushtrim: Pritshmëritë	6
2 Seancë: Fëmijëria e hershme dhe zhvillimi tërësor	7
Ushtrim: Për çfarë ka nevojë një fëmijë?	7
Fëmijëria e hershme dhe zhvillimi tërësor	8
Ushtrim: Aktorët në jetën e fëmijës	15
Ushtrim: Çfarë dimë për kopshtin	16
Arsimi parashkollor në Shqipëri	17
3. Seancë: Arsimi gjithëpërfshirës, tërësor dhe nxitës	21
Arsimi gjithëpërfshirës, tërësor dhe nxitës	21
4 Seancë: Rëndësia e krijimit të marrëdhënieve në fëmijërinë e hershme	29
5 Seancë: Bashkëpunimi prindër - mësuese	34
Ushtrim: Mite për përfshirjen e prindërve	34
Bashkëpunimi prindër - mësuese	35
Ushtrim: Tipet e bashkëpunimit	39
6 Marrëdhëniet prindër – mësuese në mbështetje të gjithëpërfshirjes dhe edukimit tërësor	40
Ushtrim: Reflektim për bashkëpunimin	40
Marrëdhëniet prindër – mësuese në mbështetje të gjithëpërfshirjes dhe edukimit tërësor	41
Barrierat në pjesëmarrjen e prindërve	45
7 Seancë: Pjesëmarrja përmes komunikimit prindër - mësuese	48
Komunikimi efektiv prind – mësuese: këshilla praktike	51
Ushtrim: Ndërtimi i marrëdhënieve	55
Ushtrim: Diskutimi i problemeve	56
Referencat	57
Shtojcë: Shembull i programit të arsimit parashkollor në Shqipëri për moshën 4 – 5 vjeçare	59

PREZANTIMI DHE NJOHJA ME PROGRAMIN E TRAJNIMIT

Qëllimet

- T'i urohet mirëseardhja të gjithë pjesëmarrësve
- Të prezantohen pjesëmarrësit me qëllimin dhe objektivat e trajnimit
- Të prezantohet programi i trajnimit dhe diskutohet fleksibiliteti në lidhje me orarin dhe detaje të tjera praktike.

Koha

10 minuta.

Metoda

Diskutim në grup.

Hapat

1. Sqarojini pjesëmarrësit për oraret e seancave dhe pushimeve dhe bini dakort së bashku mbi to.
2. Lexoni dhe shpjegoni objektivat e trajnimit dhe prezantoni shkurt programin.

Mjete pune

Flipçarte, markera, stilolapsa, kopje të programit për çdo pjesëmarrës.





USHTRIM



VENDOSJA E RREGULLAVE

Qëllimet

- Përcaktimi i rregullave të pranueshme për të gjithë pjesëmarrësit dhe vetë trajnerët
- Lehtësimi i procesit të trajnimit.

Koha

15 minuta.

Metoda

Diskutim në grup.

Hapat

1. Shpjegojini pjesëmarrësve mbi nevojën e vendosjes së rregullave.
2. Kërkojini atyre të kontribuojnë në vendosjen e rregullave. Është e rëndësishme që shumica e rregullave, apo mundësisht të gjitha, të dalin prej tyre dhe të jenë të respektueshëm nga të gjithë.
3. Shkruani të gjitha rregullat e propozuara në flipçart.
4. Pyesni pjesëmarrësit nëse janë dakort me të gjitha rregullat dhe më pas, ngjitini në një hapësirë të dukshme për të gjithë (mur, tabelë, etj).

Mjete pune

Flipçarte, markera, stilolapsa.





USHTRIM



TË NJIHEMI MË MIRË

Qëllimet

- Të prezantohen pjesëmarrësit më në thellësi me njëri-tjetrin
- Të thyhet akulli dhe të hapet diskutimi i temës kryesore të trajnimit.

Koha

20 minuta.

Metoda

Diskutim në grup.

Hapat

1. Kërkojini pjesëmarrësve të prezantojnë veten (emrin e tyre, sa fëmijë kanë, punësimi ose jo etj.).
2. Pyetini pjesëmarrësit rreth rastit të fundit të një sfide që kanë pasur me një fëmijë, me të cilin janë përballur dhe reagimin e tyre ndaj tij.
3. Shkruani përgjigjet në flipçart.

Mjete pune

Flipçart, markera.





USHTRIM



PRITSHMËRITË

Qëllimi

Identifikimi dhe diskutimi i pritshmërive, frikërave dhe shpresave të grupit të pjesëmarrësve, lidhur me trajnimin.

Koha

40 minuta

Metoda

Punë në grup dhe diskutim në grup.

Hapat

1. Shpjegojini pjesëmarrësve qëllimin e aktivitetit.
2. Ndajini ata në grupe të vogla. Kërkoni pjesëmarrësve të shkruajnë në një fletë përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme (15 minuta).
3. Çdo individ shkruan 5 shpresa dhe 5 frikëra në një fletë dhe e ngjit në mur ose në flipçart.
4. Më pas e diskutojnë në grupe të vogla dhe rikthehen në grupin e madh.

Mjete pune

Flipçart, markera, ngjitës.





SEANCE

FËMIJËRIA E HERSHME DHE ZHVILLIMI TËRËSOR

USHTRIM



PËR ÇFARË KA NEVOJË NJË FËMIJË?

Qëllimet

- Nxitja e të menduarit për nevojat e fëmijëve
- Nxitja e të menduarit për krijimin e lidhjeve midis nevojave dhe plotësimit në mjedisin e kopshtit.

Koha

40 minuta

Metoda

Punë në grup, vizatim.

Hapat

- Ndajini pjesëmarrësit në grupe prej jo më shumë se 5 anëtarësh.
- Pjesëmarrësit vizatojnë një figurë trupi të një vajze ose të një djali. Grupi i vë një emër fëmijës dhe vendos për cilësitë e tij mendore, fizike, psikologjike dhe shpirtërore. (p.sh. shëndet i mirë, sens humori, mirësi). Ata duhet t' i shkruajnë këto cilësi në anën e djathtë të trupit të fëmijës.
- Në anën e majtë do të shkruhen burimet materiale, njerëzore dhe edukative që janë të nevojshme për të arritur këto cilësi (p. sh. nëse fëmija është i shëndetshëm, duhet të ketë ushqim dhe strehim).
- Pjesëmarrësit do të përshkruajnë se çfarë do të ndodhte, në rast se këto nevoja nuk do të plotësoheshin. Në të njëjtën kohë, mund të reflektojnë për plotësimin e nevojave në mjedisin e kopshtit të tyre.

Mjete pune

Flipçarte, markera, stilolapsa.



MATERIAL LEXIMI

FËMIJËRIA E HERSHME DHE ZHVILLIMI TËRËSOR

Fëmijët zhvillohen në mënyrë të gjithanshme (holistike). Ata kanë nevojë për mbështetje që të kenë një shëndet të mirë, ushqyerje, mbrojtje, nxitje dhe të mësuarit. Për rrjedhojë, qëllimet zhvillimore dhe të të mësuarit të fëmijëve janë shumëdimensionale. Ato arrihen kur fëmijët mbijetojnë dhe bëhen të shëndetshëm fizikisht, alertë mendërisht, të sigurtë emocionalisht, të aftë në shoqëri dhe në procesin e të mësuarit, të ndërgjegjshëm kulturalisht dhe shpirtërisht dhe estetikisht krijues. Ata rriten dhe bëhen njerëz të rritur të përgjegjshëm dhe produktivë.

Përvojat e hershme të fëmijëve mund të nxisin ose të frenojnë zhvillimin e tyre të përgjithshëm, në varësi të aksesit dhe cilësisë së ushqyerjes dhe shërbimeve shëndetësore, të praktikave të përkujdesit të familjes dhe të komunitetit, të mundësive për të mësuar dhe të mbrojtjes së tyre. Ata kanë nevojë për mbështetje nga sektorë të ndryshëm. Një mbështetje e tillë jo vetëm që ka impakt tek vetë fëmijët, por ndikon dhe mjediset në të cilët jetojnë. Këto mjedise, me rradhë, ndikojnë në zhvillimin tërësor të fëmijëve.

Përqasja e zhvillimit tërësor në fëmijëri përmban: zhvillimin kognitiv (njohës), social, fizik, emocional, gjuhësor, shpirtëror, moral etj. nga faza prenatale deri në moshën 8 vjeçare. Për të pasur një zhvillim tërësor nevojiten: shëndet, të ushqyerit, stimulimi i hershëm, bashkëveprime pozitive sociale dhe emocionale me kujdestarët, loja, mundësitë e të mësuarit, dhe mbrojtja nga dhuna.

Përqasja tërësore

Koncepti “tërësor” nënkupton se diçka shqyrtohet “si tërësi”. Zhvillimi i fëmijëve bëhet në disa fusha njëherazi dhe përqasja holistike i shqyrton të gjitha ato procese si tërësi, përkatësisht zhvillimin e “gjithë fëmijës”. Kjo mënyrë është e bazuar në parimet e pranuar gjerësisht se të gjitha fushat e zhvillimit njerëzor janë të ndërlidhura mes tyre dhe se zhvillimi i fëmijëve bëhet përmes fushave zhvillimore njëherazi. Zhvillimi i secilës prej tyre në të njëjtën kohë ndihmon edhe zhvillimin e fushave të tjera. Edhe vetë e vërejmë se fëmija prej fëmijës dallohet. Edhe pse janë





në moshë të njëjtë, te disa fëmijë një tip i zhvillimit mund të ndodhë më herët, ndërsa në po atë periudhë fëmijë të tjerë mund të jenë më përpara në diçka tjetër. Siç mund ta vërejmë nga ambjenti që na rrethon, një fëmijë mund të ecë më shpejt se një fëmijë tjetër, por fëmija tjetër mund të fillojë të flasë më herët. Se cila aftësi e fëmijës do të fillojë të zhvillohet më herët dhe sa do të jetë fëmija i/e avancuar në secilën prej tyre, kjo varet edhe nga koha që kalojmë me ta dhe sa janë të suksesshme mënyrat në të cilat orvatemi t'i nxisim që të zbulojnë njohuri të reja dhe të dallojnë ligjshmëri të reja në botën përreth tyre derisa rriten dhe zhvillohen¹.

Zhvillimi dhe të mësuarit të fëmijët e vegjël zhvillohen në pesë fusha, të cilat në gjuhën profesionale quhen fusha zhvillimore:

- Zhvillimi fizik dhe motorik
- Zhvillimi socio – emocional
- Zhvillimi i gjuhës dhe shkrim – lexim i hershëm
- Zhvillimi njohës (kognitiv)
- Zhvillimi i qëndrimit ndaj mësimit

Të gjitha fushat zhvillohen në mënyrë paralele, por në moshë të ndryshme disa janë më intensive, e disa më pak. Kur fëmija ende është foshnje gjiri, më aktive janë disa fusha, kur është fëmijë i vogël – të tjerat, e kur është në moshën e vajtjes në shkollë – disa të tjera. Disa vijnë në sipërfaqe më herët, e disa më vonë.

Menjëherë pas ditëlindjes së parë, më intensiv është zhvillimi motorik, fëmija fillon gjithnjë e më shumë të lëvizë, të ecë. Më vonë, ky tip i zhvillimit fillon të pushojë dhe ia lë vendin zhvillimit njohës ose zhvillimit kognitiv, i cili vjen në shprehje pas ditëlindjes së dytë.

Njohja e fushave në të cilat bëhet zhvillimi i fëmijës, si tërësi ose veçmas, është e rëndësishme për secilin që është i përfshirë në kujdesin dhe të mësuarit e hershëm të fëmijëve të vegjël. Këto arritje dhe njohuri shkencore dhe gjithçka që buron prej tyre janë përvoja shumë të rëndësishme për zhvillimin profesional të të punësuarve në kopshtet e fëmijëve dhe në të gjitha institucionet që përfshijnë punë me fëmijë të vegjël.

Zhvillimi fizik dhe motorik

Kjo fushë e zhvillimit të hershëm të fëmijëve përfshin zhvillimin e shkathtësive fizike dhe motorike, që fillojnë të paraqiten që në moshën kur fëmijët janë ende në gjë ose fëmijë të vegjël. Kur lindin, bebet e

¹ “Fëmijëria e hershme: 5 të parat janë më të mbarat” e marrë nga <http://www.prvite5.mk/zhvillimi-i-hershem-i-femijes.nspx> e aksesuar në Shtator 2014





vogla ende nuk janë mjaft të zhvilluara që të mund ta kontrollojnë trupin e tyre. Më vonë ato fuqizohen, bëhen më stabile, fillojnë të ecin, fillojnë të vrapojnë, ngjiten shkallëve, mësojnë ta ngasin biçikletën. Këto ndryshime janë aq të mëdha, sa që nuk mund të mbeten të pavërejtura nga të rriturit që kujdesen për fëmijët.

Pasi që t'i përvetësojnë këto shkathtësi, fëmijët fillojnë të shprehen përmes sendeve që i rrethojnë dhe që janë përreth tyre. Në këtë periudhë fillojnë të lëvizin më fort dhe në mënyrë më të qëndrueshme, arrijnë të kenë kontroll ndaj të gjitha pjesëve të trupit, bëhen të vetëdijshëm për hapësirën në të cilën lëvizin dhe fillojnë që gjithnjë e më lëvizshëm ta hulumtojnë ambientin e tyre. Zhvillimi i sistemit të lëvizjes dhe forcimi i trupit është një pjesë e rëndësishme e zhvillimit të fëmijëve të vegjël – i ndihmon edhe në gjëra të tjera në vazhdim që janë të lidhura me zhvillimin e fëmijës.

Zhvillimi socio-emocional

Zhvillimi socio-emocional nënkupton marrëdhëniet që zhvillojnë fëmijët derisa janë të vegjël me të rriturit dhe me fëmijët e mjedisit të tyre. Çështje të rëndësishme të kësaj fushe janë: cila është përvoja që e përvetësojnë derisa këmbejnë diçka me mjedisin, si reagojnë ndaj të njohurve dhe të panjohurve, sa të lehtë ose vështirë e kanë të vendosin marrëdhënie të mira me të tjerët, sa ia dalin t'i kontrollojnë ndjenjat e tyre etj.

Në këtë periudhë fëmijët mësojnë se si ta njohin dhe si ta kuptojnë atë që ndjejnë ata vetë ose atë që ndjejnë të tjerët, mësohen si të miqësohen me njerëzit dhe fëmijët përreth tyre, si ta shprehin atë që ndjejnë, si ta kontrollojnë sjelljen e tyre, si të kuptohen më lehtë me ambientin që i rrethon.

Zhvillimi i këtyre përvojave dhe shkathtësive i ndihmon fëmijët që të gjenden më lehtë në grupe më të mëdha, të marrin pjesë në aktivitete grupore dhe të kënaqen me mbështetjen që i ofron mjedisi i tyre. Fëmijët e vegjël janë veçmas të ndjeshëm ndaj asaj se si pranohen nga mjedisi i tyre dhe cilat janë qëndrimet e njerëzve të mjedisit që i rrethon ndaj tyre dhe ndaj ideve që shprehin.

Zhvillimi i gjuhës dhe shkrim-lexim i hershëm

Gjuha është e përbërë nga katër pjesë – dëgjimi, të folurit, leximi, shkrimi – dhe zhvillimi i saj fillon menjëherë pas lindjes. Derisa janë bebe, fëmijët fillojnë “të bisedojnë” me njerëzit përreth tyre, të komentojnë botën përreth tyre, duke përdorur zëra dhe tinguj të ndryshëm. Ekzistojnë





disa parime për zhvillimin e gjuhës dhe të folurit, të cilat vlejné për të gjithë, por çdo fëmijë i zhvillon aftësitë gjuhësore në mënyrën e tij/saj. Përvojën më të madhe gjuhësore fëmijët e marrin kur arrijné në moshën para se të shkojnë në shkollë. Shpejtësia me të cilën do të zhvillohet gjuha e fëmijës varet nga shumë gjëra, por më së shumti varet nga ajo se si dhe sa bisedojné me ata që nga koha kur janë të vegjël.

Zhvillimi njohës

Zhvillimi njohës i fëmijëve dhe ndërveprimi i tyre me botën varet sërish nga të rriturit. Nga qëndrimet e të rriturve të mjedisit të tyre ndaj fëmijëve varet edhe ajo se a do të kenë fëmijët mundësi që ta ndërtojnë njohurinë e fituar me informacione të reja dhe sa do të mësojnë që ato informacione t'i përdorin në jetën e përditshme me njerëzit ku jetojnë dhe zhvillohen. Kjo është një periudhë e rëndësishme, kur fëmijët përvetësojnë bazat e matematikës, fillojnë të mendojnë në mënyrë më logjike, fillojnë të ballafaqohen me situata problemore.

Kjo fushë lidhet me mënyrën se si fëmijët mësojnë, e jo se çfarë mësojnë. Fëmijët e vegjël, sipas natyrës së tyre, janë kureshtarë dhe dëshirojnë të hulumtojnë. Krijimi i mjedisit pozitiv për mësim i nxit fëmijët të hulumtojnë, të zgjidhin probleme, të jenë iniciues, kureshtarë dhe të parashatrojnë pyetje. Në një mjedis të tillë fëmijët zhvillojnë qëndrim pozitiv ndaj të mësuarit, i cili është shumë i rëndësishëm për suksesin e mëtejshëm në shkollë, por edhe për procesin e mësimin aktiv gjatë gjithë jetës.

Qëndrimi ndaj të mësuarit

Secilit fëmijë duhet t'i mundësohet përvetësimi i përvojave përmes procesit të mësimin që përkohné me nevojat, mundësitë dhe potencialet e tyre të vetme. Qasja fëmijërore ndaj mësimin lidhet edhe me motivacionin, sjelljen dhe stilet kognitive që fëmijët i demonstrojnë kur mësojnë diçka të re. Fëmijët duhet të jenë të motivuar dhe të përdorin njohuritë dhe aftësitë e përvetësuarat. Në fëmijërinë e hershme vendoset bazat e të mësuarit të përjetshëm.

Hulumtimet që janë bërë në disa shkenca të ndryshme – antropologji, psikologji zhvillimore, mjekësi, shkenca sociale – flasin se përvojat e fëmijëve në fëmijërinë e hershme janë faktorë të rëndësishëm për zhvillimin e inteligjencës, personalitetit dhe marrëdhënies që do krijojë fëmija me të tjerët.

Nëse janë të anashkaluar, nëse nuk u përkushtohemi sa duhet që t'i ndihmojmë të krijojnë marrëdhënie të mira me mjedisin, që të mësohen t'i kontrollojnë emocionet e veta në këtë periudhë, gjithë kjo do të reflektohet në mënyrë negative në periudhat e mëvonshme të jetës.





Nuk mjafton që fëmija të jetë mjaft i ushqyer dhe i shëndetshëm. Zhvillimi i fëmijëve njëherazi është edhe zhvillim në më shumë fusha. Gjithçka është e lidhur me njëra – tjetrën dhe nëse ndonjëra nga ato anashkalohet, ekziston rrezik që fëmija të mos e përdorë plotësisht potencialin e tij; kjo vlen veçmas për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.²

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve në mënyrë të veçantë e thekson rëndësinë e zhvillimit të hershëm të fëmijës dhe përcakton se secili fëmijë ka të drejtë ta zhvillojë deri në nivelin më të lartë potencialin e tij zhvillimor, ndërsa vendet anëtarë të Kombeve të Bashkuara detyrohen që secilit fëmijë t'i sigurojnë standardet që do t'i mundësojnë zhvillim fizik, mendor, shpirtëror dhe social³.

Situatat stresuese në të cilat fëmija është i ekspozuar në fëmijërinë e hershme – grindjet në familje, sjellja agresive e dikujt në mjedisin e tij – mund të ndikojnë që më vonë në jetën e fëmijës të shfaqen vështirësi në zhvillimin e proceseve mendore dhe në të mësuar, në shprehjen dhe kontrollimin e ndjenjave të tyre, si dhe në probleme që mund të dalin në krijimin e marrëdhënieve të mira me njerëzit përreth tij. Dukuritë e tilla mund ta ngadalësojnë përgatitjen e fëmijës për shkollë dhe të jenë shkak që fëmija të arrijë rezultate më të dobëta gjatë shkollimit në shkollë të mesme dhe në atë të lartë⁴.

Sipas statistikave, fëmijët e familjeve vulnerable kanë pasoja të shumëfishta nga varfëria dhe përfundojnë më pak vite shkollë se moshatarët e tyre të shtresave më të pasura. Shkak për këtë është motivimi më i vogël dhe kapaciteti më i vogël për mësim. Mundësia që këta fëmijë të ndihmohen të kenë fillim sa më të barabartë në procesin arsimor, është fëmijëria e hershme, si periudhë në të cilën ndodhë zhvillimi intensiv i trurit dhe kur vendosen bazat e zhvillimit mendor dhe socio-emocional.

Përkushtimi ndaj zvogëlimit të varfërisë dhe rritjes së mundësive të të gjithë fëmijëve që të kenë sukses në arrijtjet arsimore kërkon investim më të madh në fëmijërinë e hershme dhe integrim në ndërhyrjet shëndetësore, sociale dhe arsimore në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Sa më shumë që investohet në krijimin e kushteve për zhvillim cilësor të fëmijës në rininë e hershme, aq më pak duhet të investohet në zhvillimin e tij në periudhat e mëvonshme të zhvillimit të tij.

Sigurimi i zhvillimit të shëndetshëm kognitiv dhe socio-emocional të çdo fëmijë meriton të jetë prioritet më i lartë i secilës qeveri të përgjegjshme, bashkësi lokale të përgjegjshme dhe familje të përgjegjshme me fëmijë të vegjël.

2 Damovska, L., Shehu, F., Janeva, N., Palçevska, S. dhe Panova, L.S. (2009). "Zhvillim i hershëm i fëmijëve: Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijëve në moshë prej 0-6 vjecc". Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Maqedoni.

3 OKB (1989). Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, Neni 6.

4 Karaj, Dh. (2005). *Psikologjia e Zhvillimit të Fëmijës*. Progress:Tiranë





“Si ka qenë me mësimet?” Arritjet akademike në kopsht, çfarë duhet të kemi parasysh!

Prindërit e një vajeje 4 – vjeçare shkuan në mbledhjen e prindërve në kopsht dhe atje dëgjuan mësuesen e vetë teksa po i shpjegonte se ka vështirësi me gërshërën dhe është paksa mbrapa fëmijëve të tjerë në njohjen e shkronjave dhe të numrave. Prindërit kanë shokuar mësuesen kur janë përgjigjur se ata ishin më shumë të interesuar për “zemrën” e fëmijës së vet, për karakterin e saj se sa për arritjet akademike. A ishte një fëmijë i dhembur? A i respektonte mësueset dhe shoqet/ët e saj? A ishte e lumtur?

Kjo histori ilustron më së miri disa prirje të fundit në institucionet parashkollore në Shqipëri dhe në vende të tjera. Prirja më shqetësuese lidhet me natyrën akademike të kopshteve. Shumë studime kanë treguar se të mësuarit në mënyrë akademike që prodhohet që në kopshte zhduket deri sa fëmijët të shkojnë në klasën e tretë⁵. Njohuritë e përfutuara në kopsht janë të imponuara, të mësuara artificialisht, prandaj janë thjesht humbje kohe! Nga ana tjetër, ka studime që tregojnë se ka një lidhje mes të mësuarit e hershëm (që në kopsht) dhe vështirësive në të nxënë të një të ardhme. Mësueset duhet të jenë të ndërgjegjshme për këto studime; në vend të asaj ato nganjëherë vazhdojnë punën e tyre me ABC – në, me numra dhe me të lexuarit bazuar në gjuhën e plotë (diçka që është lidhur me vështirësi në të nxënë) me fëmijët e moshës parashkollore. Pse?

Sipas psikologut të familjes John Rosemond (2014)⁶ përgjigja ka dy anë: së pari, prindërit (veçanërisht nënat) janë shumë ankthiozë për performancën akademike të fëmijëve të tyre. Në kultura të ndryshme me sa duket, ka një lidhje të pashkruar, sipas së cilës nënat që kanë fëmijë me performancë akademike më të lartë, janë nëna më të mira. Për rrjedhojë, prindërit e sotmë mendojnë se nëse do të harxhojnë para për të regjistruar fëmijën e tyre në kopsht (publik ose privat), atëherë kopshtet duhet të demonstrojnë dhe të provojnë se janë të vlefshme. Këtë e arrijnë vetëm nëse i mësojnë fëmijëve shprehi dhe njohuri akademike dhe gjëra të tjera, të cilat do të jenë të pavlefshme për vazhdimin e jetës së tyre, në mos të dëmshme.

Së dyti, institucionet parashkollore detyrohen që të përshtatin programet e tyre duke i dhënë një natyrë më shumë akademike në mënyrë që të jenë konkurruese (ka raste që edhe në Shqipëri prindërit nuk preferojnë të çojnë fëmijën e tyre në një kopsht ku fëmijët luajnë më

5 Elkind, D. (2001). The hurried child. Growing up too fast too soon. Perseus Publishing.

6 Rosemon, J. (2014). Living with children: Even in pre-school parents want a 'Trophy Child'. E marre nga <http://www.gastongazette.com/lifestyles/family/living-with-children-even-in-pre-school-parents-want-a-trophy-child-1.405463> e aksesuar ne Tetor 2014





shumë, ndërsa e çojnë në një tjetër që mësojnë shkronjat dhe numrat që në moshën 4 -5 vjeçare! Dhe ky është rasti i kopshteve publike...). Kopshtet duhet të premtojnë se do të ushqejnë nevojat e prindërve për të pasur fëmijë me performancë të lartë. Nga ana tjetër, në vende si Shqipëria nuk mund të lihet pa përmendur dhe fakti se ky është një mentalitet i trashëguar edhe tek mësueset, dhe është trashëguar nga e kaluara jonë, e cila ishte tepër e orientuar ndaj arritjeve. Kështu, vitee e çmuara të moshës parashkollore, kur fëmijët duhet të lejohen të luajnë dhe të eksperimentojnë sakrifkohen në altarin e “**Fëmijës Trofe**” .

Në historinë e treguar më sipër duhet të thuhet se mësuesja, pasi u përmend nga shoku, i tha prindërve se do të donte të kishte më shumë prindër si ata, me këtë qëndrim ndaj fëmijëve të tyre.

Duhet të tërhiqet vëmendja për rreziqet e ekspozimit të fëmijëve tanë në presione të shumta, të cilët mund të çojnë në një sërë krizash të fëmijërisë dhe të adoleshencës më vonë. Është treguar se kur kufijtë e të mësuarit të përshtatshëm nga ana zhvillimore janë turbulluar, duke pritur ose duke imponuar shumë gjëra dhe shumë herët dhe shumë shpejt për fëmijët. Në këtë mënyrë fëmijët detyrohen të rriten shumë shpejt dhe shumë herët. Ka shumë raste që prindërit e brezave të rinj dhe më të vjetër “nxitojnë” fëmijët e tyre që të rriten, duke i humbur kështu përgjithmonë fëmijërinë e tyre.

Fëmijët janë burimi dhe ndërtuesit e eksperiencës së vetë, janë pjesëmarrës aktivë në organizimin e identiteteve të tyre, të aftësive dhe autonomisë përmes marrëdhënieve dhe ndërveprimit me shokët dhe shoqet e tyre, me mësueset, me prindërit, me idetë, me objektet dhe me ngjarje të vërtate dhe imagjinare në botë që komunikojnë me njëra – tjetrën.⁷

7 Fabbi, C. (2014). Guidelines for ECDC in Albania. Save the Children.





USHTRIM



AKTORËT NË JETËN E FËMIJËS

Qëllimet

- Nxitja e të menduarit për njerëzit e rëndësishëm në jetën e fëmijës dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e fëmijëve
- Nxitja e të menduarit për ndërthurjen e këtyre marrëdhënieve dhe ndikimin në zhvillimin e fëmijëve

Koha

40 minuta

Metoda

Disktum në grup

Hapat

- Pjesëmarrësit listojnë në gjithë aktorët/njerëzit e rëndësishëm në jetën e një fëmije.
- Më pas diskutojnë mbi rëndësinë e këtyre marrëdhënieve në një grup të madh
- Në vazhdim pjesëmarrësit ftohen të mendojnë për ndikimin e tyre në zhvillimin e fëmijës dhe ndërlidhjen mes tyre

Mjete pune

Flipçarte, markera, stilolapsa.





USHTRIM

ÇFARË DIMË PËR KOPSHTIN

Qëllimet

- Nxitja e të menduarit për njohuritë për kopshtin
- Nxitja e të menduarit për njohuritë për aftësitë që mësojnë fëmijët në kopsht?

Koha

15 minuta

Metoda

Diskutim në grup

Hapat

1. Trajneri i fton pjesëmarrësit të mendojnë për pyetjet e mëposhtme
 - Cilat janë fushat kryesore që mësojnë fëmijët në kopsht?
 - Përse këto fusha janë të rëndësishme për fëmijët?
 - Cilat nga këto mendoni se ofrohet në kopsht dhe cila anashkalohet?
 - Si lidhen kompetencat e ndryshme me njëra – tjetrën?
 - Si mund të jetë një lojë/aktivitet/aplikacion që lidhet me këtë fushë?
2. Diskutohet në grup të madh për përgjigjet e prindërve.

Mjete pune

Flipçarte, markera, stilolapsa.



MATERIAL LEXIMI

ARSIMI PARASHKOLLOR NË SHQIPËRI

Arsimi parashkollor përbëhet nga çerdhet dhe kopshtet. Çerdhet janë institucione në vartësi të pushtetit vendor dhe përfshijnë fëmijë të grup moshës (0 - 3) vjeç. Kopshtet janë institucione në vartësi të MAS dhe përfshijnë fëmijë të grup moshës (3 - 6) vjeç. Arsimi parashkollor nuk është i detyruar. Ka dy lloje kopshtesh, kopshte gjithëditore dhe kopshte gjysmëditore. Kopshtet funksionojnë gjatë gjithë vitit.

Procesi mësimor edukativ në arsimin parashkollor zhvillohet mbi bazën e programeve edukative të miratuara nga MAS. Misioni i kopshtit është që, në bashkëpunim me prindërit, të realizojë edukimin dhe zhvillimin e personalitetit të fëmijëve dhe t'i parapërgatit ata për në shkollë. Në kopshte, fëmija vepron, eksperimenton, reagon dhe bashkëvepron me të tjerët në një mjedis të organizuar për qëllime edukative dhe të zhvillimit të plotë të tij/saj. Për pasojë, si familja edhe kopshti synojnë të drejtojnë dhe nxisin zhvillimin psikologjik të fëmijës përmes eksperiencash të ndryshme edukative që kompletojnë zhvillimin e tij/saj. Baza e zhvillimit psikologjik të individit formohet pikërisht në vitet e para të jetës së tij/saj.

Për programet parashkollore në vendet e zhvilluara të Europës është karakteristike:⁸

A- Përfshirja e prindërve në realizimin e programeve (prindërit përfitues të programit, prindërit bashkëkrijues dhe realizues të programit).

B- Plotësimi i nevojave të fëmijëve parashkollorë dhe të familjeve të tyre, sidomos për fëmijët nga mjedise sociale e kulturore të marginalizuara, me gjendje materiale të vështirësuar, për fëmijët emigrantë dhe fëmijët në vështirësi (talentet dhe fëmijët me nevoja të veçanta).

⁸ "Institucionet arsimore" (2014). E marre nga [http:// data.planetar.edu.al](http://data.planetar.edu.al) e aksesuar ne Shtator 2014





Sipas të dhënave të UNESCO-s, përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor, një vit para fillimit të shkollës, në vendet e zhvilluara të Europës është tepër e lartë (për shembull, në Itali mbi 96%, në Hollandë 100%, në Spanjë rreth 70%, në Francë rreth 100% etj.).

Sistemet parashkollore të Europës Qendrore dhe Lindore pak nga pak po e lënë edukimin parashkollor tradicionalisht të didaktizuar dhe me orientim shkollor. Veç kësaj, bëhen përpjekje për të realizuar marrëdhënie partneriteti ndërmjet prindit dhe mësueses, si formë e ndarjes së përgjegjësisë për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve.

Në programet e rregullta dhe veprimtari të tjera realizohen disa detyra programore, si :

- A- kujdesi për shëndetin dhe zhvillimin fizik të fëmijëve;
- B- puna mësimore - edukative për të gjithë fëmijët, bazuar në nevojat dhe interesat e tyre, në përputhje me ndodhitë natyrore dhe shoqërore dhe me pasurimin cilësor të jetës së përditshme në kopshte;
- C- specifikat e punës me fëmijët që paraqesin nevoja të veçanta (fëmijët e talentuar dhe ata me nevoja të veçanta).

Drejtime të edukimit në arsimin parashkollor

Në grupmoshën 3-6 vjeç, kujdes të veçantë i jepet:

- 1- kontrollit progresiv të lëvizjes;
- 2- zhvillimit të gjuhës si mjet komunikimi, imagjinate dhe meditim;
- 3- krijimit të mjeteve të tjera të komunikimit dhe shprehjes;
- 4- nxitjes së kuriozitetit, aftësive vëzhguese dhe krijuese;
- 5- zbulimit të karakteristikave dhe veçorive të mjedisit fizik ku lëviz fëmija;
- 6- krijimit të një imazhi pozitiv dhe të ekuilibruar;
- 7- stimulimit të marrëdhënieve sociale, të karakterizuara nga bashkëekzistenca dhe bashkëpunimi;
- 8- zhvillimit të qëndrimeve dhe shprehive (zakoneve) për përkujdesin që duhet treguar për trupin dhe mjedisin;
- 9- forcimit të respektit dhe tolerancës ndaj dallimeve mes personave të ndryshëm.

Edukimi në arsimin parashkollor rekomandohet të jetë i një natyre globale dhe gjithëpërfshirëse. Në situatat dhe eksperiencat e ndryshme duhen përfshirë sa më shumë aspekte që të jetë e mundur, pa e fragmentarizuar jetën e një fëmije me pjesë, që më vonë e ndajnë kohën e tyre në fusha dhe më pas në lëndë.





Në arsimin parashkollor vlerësohen fusha të mbështetura më shumë në eksperiencë sesa në programe mësimore dhe duhet theksuar fakti që ky edukim është i lidhur më shumë me veprimtari që kryhen nga fëmijët për të arritur qëllime të caktuara edukative, sesa me çështje apo koncepte që diktohen nga të rriturit.⁹

Përgatitja për kopshtin

Në një çast në jetën e tyre, fëmijët do të shkojnë në kopsht. Ata mund të fillojnë që në moshën 3 vjeç, ose edhe më vonë. Disa fëmijë mund të ishin më përpara në çerdhe dhe të vazhdojnë me kopshtin. Përkujdesësit duhet të marrin parasysh një sërë faktorësh (përveç moshës kronologjike) kur të përcaktojnë nëse fëmija është gati për kopsht.

KËSHILLA PËR TA BËRË MË TË LEHTË FILLIMIN E KOPSHTIT

- **Diskutoni për kopshtin**

Në javët para se të fillojë kopshtin, diskutoni me fëmijën tuaj. Shprehni entuziazëm për gjithë ato gjëra që ka për të mësuar dhe për të bërë. Përpuni të merrni përgjigje nga ai, për të parë sesi ndihet. Mos e teproni me diskutimin e çështjes nëse fëmija nuk është i interesuar, apo nuk dëshiron ta diskutojë. Ideja është që kopshti të duket shumë interesant për fëmijën dhe jo diçka që duhet ta ketë frikë.

- **Kaloni kohë larg**

Para se të shkojë në kopsht, mund të shikoni sesi përballet me ankthin e ndarjes. Proveni ta lini në një të afërm ose në një mik të familjes, ose propozojini që të flejë në shtëpinë e gjyshes. Shikoni sesi reagon fëmija juaj larg jush, në një mjedis të mirë dhe të mbikëqyrur.

- **Merrni diçka nga shtëpia**

Pyeteni fëmijën nëse do të donte të merrte diçka nga shtëpia, në ditën e parë të kopshtit. Nxiteni të zgjedhë diçka të vogël dhe rehatuese, si një kukull ose një lodër të preferuar. Prania e një objekti të njohur mund t'i japë ndjesinë e sigurisë në mjedisin e ri.

- **Ndihmoni fëmijën të orientohet**

Ditën e parë, kaloni pak kohë në kopshtin e fëmijës. Prezantoheni me edukatoren dhe me fëmijët e tjerë dhe tregojini banjën, vendin ku hahet dreka dhe vendin ku do të varë rrobat (trikon, pallton etj.) e tij.

- **Reagoni ndaj stresit**

Nëse fëmija është shumë ankthioz, mos i tërhiqni vëmendjen apo ta tallni për sikletin që përjeton dhe mos u përpuni ta manipuloni për t'u sjellë më mirë. Vetëm jini të gëzuar, të këndshëm dhe përsërisni se do të ktheheni për ta marrë në fund të ditës. Rikujtojini se do të mësojë gjëra interesante dhe merreni për të folur me edukatoren.

- **Thoni 'mirupafshim'**

Bëni një "mirupafshim" të gëzuar dhe të shkurtër. Mos u ktheni pasi e keni përhëndetur dhe mos ikni nga dhoma fshehtas. Disa fëmijë pëlqejnë një ritual të përhëndetjes, siç janë dy përqaqimet apo një përhëndetje e fshehtë nga dritarja. Përsëri, kujtojani se kur do të ktheheni dhe kujdesuni të mos vonoheni për t'u kthyer dhe për ta marrë.

⁹ Për më shumë informacion shih Shtojcat: "Shembull i programit të arsimit parashkollor në Shqipëri"





Për të ndihmuar përshtatjen në kopsht nevojiten një sërë sjelljesh. Për shembull, fëmijët duhet të jenë të aftë të marrin pjesë në një aktivitet grupi; të dëgjojnë një histori dhe të jenë të aftë ta shpjegojnë e të krijojnë një rrjedhë logjike të thjeshtë të historisë; të ndjekin udhëzime të thjeshta për një lojë apo aktivitet të ri; të jenë të aftë të shprehin qartë nevojat dhe dëshirat e tyre dhe të bëjnë pyetje me përdorimin e gjuhës. Nga ana fizike duhet të jenë të aftë të hidhen në vend, të hidhen dhe të kërcëjnë. Nga ana mendore, duhet të njohin ngjyrat dhe format bazë, si dhe të dallojnë tingujt e ndryshëm dhe të ngjashëm. Ata duhet të jenë të aftë të presin letër me gërshtë dhe të vizatojnë forma të thjeshta. Ç'është më e rëndësishmja, fëmijët duhet të jenë të trajnuar për tualetin, si dhe të kryejnë nevoja të thjeshta vetjake, si larja e duarve dhe veshja – zhveshja.

Është e vështirë të parashikohet sesi një fëmijë do të manaxhojë ndarjen në ditën e parë të kopshtit. Disa fëmijë do të mbahen fort nga mami me tmerr në sy, ndërsa të tjerë do të ikin me vrap, pa e kthyer kokën për të parë mamin, shumë të lumtur. *Fillimi i kopshtit është një hap i rëndësishëm për fëmijët dhe stresi që përjetojnë është një pjesë normale e procesit të zhvillimit.*



SEANCE

MATERIAL LEXIMI

ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS, TËRËSOR DHE NXITËS

Çfarë është arsimi gjithëpërfshirës?

Arsimi gjithëpërfshirës ka për qëllim të adresojë nevojat e të nxënësve të TË GJITHË fëmijëve dhe në veçanti përqendrohet në ata fëmijë të cilët ndihen të përjashtuar. Arsimi gjithëpërfshirës nënkupton që të gjithë fëmijët mund të mësojnë bashkë duke pasur qasje në të gjitha aspektet e edukimit dhe të pjesëmarrjes aktive në zhvillim.

Roli dhe kuptimi i gjithëpërfshirjes

Gjithëpërfshirja në kuptimin më të gjerë nënkupton marrjen parasysh të çdo rrethane, e cila e pengon aksesin në arsim cilësor me format e tij të ndryshme:

- Fëmijët vajza
- Fëmijët nga familjet e varfëra/me gjendje ekonomike jo të favorshme
- Fëmijët nga zonat e rurale/të largëta
- Fëmijët e komuniteteve pakicë
- Të kthyerit dhe fëmijët nga diaspora
- Fëmijët me nevoja të veçanta arsimore:
- Fëmijët me aftësi të kufizuara (fizike, vizuale, në të dëgjuar, intelektuale, zhvillimore)
- Fëmijët me vështirësi sociale, emocionale dhe në sjellje
- Fëmijët që vuajnë nga sëmundja ose trauma
- Fëmijët me vështirësi në të nxënë
- Fëmijët e talentuar dhe me prirje të veçanta

Gjithëpërfshirja është:

- Qasje e cila mbështet të drejtat e njeriut;
- E kundërta e diskriminimit dhe mund të “ngrohë” atmosferën në institucionin parashkollor, duke e shndërruar atë në një vend mirëpritës për të gjithë fëmijët;
- Grup strategjik për përfshirjen e të gjithë fëmijëve/grupeve;





Të rriturit dhe mësueset duhet të:

- Krijojnë sfida të përshtatshme për të nxënëit për të gjithë fëmijët,
- Të përgjigjen në nevojat e ndryshme të të nxënëit të fëmijëve,
- Tejkalojnë pengesat e mundshme për të nxënëit e individëve të veçantë dhe të grupeve të veçanta të fëmijëve dhe për vlerësimin e tyre.

Mësimdhënia e diferencuar dhe të nxënëit e diferencuar paraqesin një metodë të përfshirjes së të gjitha grupeve vulnerable dhe qasjen kryesore për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Diferencimi paraqet përqasjen ndaj mësimdhënies me të cilën sigurohet që të gjithë fëmijët mësojnë mirë, përkundër dallimeve të shumta që kanë mes tyre. Diferencimi arrihet me strategji, e jo me rezultate në të nxënëit, prandaj duhet të përqendrohemi pikërisht në to.

Si mund ta krijojnë mësueset diferencimin në klasat e tyre?

Këtë mund ta bëjnë në tri mënyra:

- *Diferencimi për nga rezultatet*, ku të gjithë fëmijëve u jepet detyra e njëjtë, ndërsa diferencimi bëhet në bazë të përgjigjeve të tyre.
- *Diferencimi për nga detyrat*, ku fëmijëve u jepen detyra specifike në varësi të aftësive që kanë. Detyrat mund të diferencohen për nga niveli i vështirësisë, sasia e strukturës, ose sasia e udhëzimeve që u janë dhënë, ose me anë të kombinimit të këtyre tre faktorëve.
- *Diferencimi për nga përpjekja e mësueses*, ku duhet bërë përshtatja e nivelit të ndërhyrjes së mësueses.

GJITHËPËRFSHIRJA E SUKSESSHME KËRKON NDRYSHIME NË:

- o Rolet e stafit
- o Bashkëpunimin kopsht - familje
- o Politikat e programeve
- o Mënyrat me të cilat krijohen dhe zhvillohet miqësotë mes fëmijëve
- o Mjedisin e klasës
- o Praktikay e disiplinimit
- o Praktikay e dhënies së udhëzimeve

Përparësitë e diferencimit me anë të detyrës qëndrojnë në mundësinë për t'i përshtatur aktivitetet me aftësitë e fëmijëve, në mënyrë që të gjitha nivelet e aftësive të rezultojnë me sukses. Ndërsa, mangësia e tij është që kërkon shumë planifikim. Përveç kësaj, mësueset





duhet t'i njohin mirë fëmijët dhe aftësitë e tyre dhe duhet t'ua kenë shpjeguar pse secili ka detyra të ndryshme. Është me rëndësi të theksohet fjala **diferencë** dhe të shmanget përdorimi i nocioneve më i lehtë/i vështirë, më i thjesht /sfidues, më i mirë-më i keq, më shumë-më pak, dhe/ose të ngjashme.

Diferencimi më anë të përpijekjes së mësueses më së miri mundësohet dukë bërë pyetje të hapura, të cilat NUK nënkuptojnë përgjigje të pritura, por promovojnë diskutimin dhe debatin. Kjo qasje i mundëson të gjithë fëmijëve të përjetojnë arritje pozitive dhe të tregojnë arritjen në nivelin e tyre më të lartë.

Mbështetja e të gjithë fëmijëve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në komunitetet e tyre kërkon që ata të kenë një fëmijëri të hershme cilësore. Programet gjithëpërfshirëse të fëmijërisë së hershme me cilësi të lartë kanë tre komponentë kyç: 1. ato janë të aksesueshme për të gjithë fëmijët dhe familjet e tyre 2. ato janë të hartuara dhe projektuar në përputhje me nevojat unike të çdo fëmije dhe 3. përfshijnë një vlerësim të vazhdueshëm të programeve për të siguruar një pjesëmarrje të plotë.

Në programet e përkujdesit të fëmijërisë së hershme të gjithë fëmijët kanë mundësi të zhvillojnë aftësitë e tyre gjuhësore, sociale, fizike, emocionale dhe njohëse. *Gjithëpërfshirja në fëmijërinë e hershme nuk është vetëm vendosja e fëmijës në një program të caktuar, por është pjesëmarrja aktive në ndërveprimet sociale si dhe zhvillimin e aftësive dhe shprehive të fëmijëve.*

Komponentët kyç për mjedisin gjithëpërfshirës¹⁰

Aksesi. Në mënyrë që një institucion të ofrojë akses për të gjithë fëmijët duhet të ketë:

- Politika që promovojnë gjithëpërfshirjen
- Një lider/udhëheqës që mbështet gjithëpërfshirjen dhe
- Staf që beson në gjithëpërfshirjen

Marrëdhëniet mes shërbimeve dhe profesionistëve duhet të jenë të koordinuara dhe bashkëpunuese. Sektorët e ofrimit të shërbimeve janë: i shëndetësisë, i arsimit, i shërbimeve sociale dhe i shërbimeve të përkujdesjes. Këto ekipe profesionistësh mbështesin vlerësimin, planifikimin, projektimin e përshtatjeve dhe ndryshimeve dhe vlerësimin. Një shembull mund të jetë një mjek familjeje, i cili bashkëpunon me kopshtin për një fëmijë që ka problem në ndërveprime sociale dhe ai e ka ndjekur që kur ishte i/e vogël.

¹⁰ Underwood, K. (2013). *Everyone is welcome: inclusive early childhood education and care*. Queen's printer for Ontario.





Projektimi dhe zbatimi. Një mjedis është gjithëpërfshirës kur:

- Programi që zbaton është hartuar që të përmbushë nevojat e të gjithë fëmijëve dhe familjeve (program universal)
- Planifikimi është i individualizuar dhe është i qartë qëllimi i pjesëmarrjes
- Qëllimet e ndërhyrjeve të hershme për fëmijët janë të përfshira në program (diferencimi dhe puna individuale)

Burimet fizike që janë të rëndësishme për praktikën gjithëpërfshirëse përmbajnë një mjedis gjithëpërfshirës që ofron materiale të adaptuara, pajisje të posaçme etj. Për shembull, mjediset që janë të projektuara për të ofruar zona të qeta dhe aktive janë të mira për fëmijët me nevoja të caktuara shqirose dhe të vëmendjes. Gjithashtu, mjediset dhe programet gjithëpërfshirëse janë ato që respektojnë ritmin e natyrshëm të zhvillimit të një fëmije si dhe kontekstin familjar.

Në mjediset gjithëpërfshirëse zakonisht çdo fëmijë ka një dosje personale, në të cilën gjenden të gjitha aktivitetet dhe rutinat në programin e vetë, të para dhe nga perspektiva e fëmijës. Këto informacione mund të ndahen dhe me profesionistë të tjerë me lejen e familjes. Qëllimi i mbajtjes së dosjes nuk duhet të jetë medoemos zhvillimi i quajtur “normal” i fëmijës, sesa pjesëmarrja e të gjithë fëmijëve. Në terma praktikë, kjo do të thotë se fëmija duhet të ketë mundësi të jetë fizikisht aktiv/e, të argëtohet dhe të bëjë shoqëri¹¹.

Monitorimi dhe vlerësimi. Fëmijët dhe familjet vazhdojnë të jenë të përfshirë kur:

- Profesionistët përgjigjen në ndryshimet zhvillimore të fëmijëve dhe në ndryshimet në jetën e familjes;
- Mjediset dhe programet përkatëse janë fleksible, të përgjegjshme dhe të përdorin informacione të rifreskuara për të planifikuar dhe për të marrë vendime
- Ka një tranzicion të mirë nga fëmijëria e hershme në shkollë.

Cilat janë karakteristikat e arsimit holistik dhe gjithëpërfshirës?

Një arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët është ai që i ofron secilit: “mundësitë për të marrë shërbime efektive edukative, me shërbimet dhe materialet e tjera mbështetëse të nevojshme, në klasa në përshtatje me moshën, në mënyrë që të përgatiten për të pasur jetë productive dhe për të qenë anëtarë të plotë të shoqërisë”

¹¹ Rosenbaum, P. & Gorter, J.W. (2011). The ‘F-words’ in childhood disability: I swear this is how we should think! *Child: care, health, and development*, 38 (4), 457-463





Tre parimet bazë të fëmijërisë së hershme që mund të përdoren në mënyrë kolektive për të patur programe dhe shërbime cilësore të fëmijërisë së hershme janë: akses, pjesëmarrja dhe mbështetja. Që të treja janë të nevojshme për të siguruar se nevojat dhe prioritetet e të gjithë fëmijëve dhe familjeve të tyre përmbushen.

VLERËSIMI I MJEDISIT TË KOPSHTIT PËR PRAKTIKAT GJITHËPËRFSHIRËSE (Melinda Raab & Carl Dunst, 1997)

Lista e mëposhtme është përshtatur për të vlerësuar cilësinë e programit dhe të mjedisit gjithëpërfshirës në institucionet e arsimit parashkollor

Filozofia dhe themelet e programit – Programet me cilësi të lartë:

- Udhëhiqen nga një filozofi e përkohshme qartë;
- Kanë qëllime dhe objektiva të shkruara
- Promovojnë partneritetin me prindërit

Menaxhimi dhe trajnimi – Në programet me cilësi të lartë drejtuesi:

- Komunikon pritshmëritë tek stafi
- Viziton klasat rregullisht dhe monitoron performancën e stafit
- Ofron mbështetje të vazhdueshme dhe feedback
- Rregullon trajnimet e vazhdueshme për stafin

Organizimi i mjedisit fizik – Programet me cilësi të lartë:

- Kanë klasa të hapura të ndara qartë në fusha të të mësuarit
- Kanë pajisje dhe mobilje të përshtatshme dhe në madhësinë e fëmijëve
- Përzgjedhja e materialeve është e mjaftueshme, e aksesueshme nga fëmijët dhe e përshtatshme me zhvillimin e tyre

Stafi – Në programet me cilësi të lartë:

- Orari dhe përgjegjësitë e stafit janë të përcaktuara dhe të zbatuara
- Stafi përgatitet më përpara për aktivitetet
- Stafi ka kohë të planifikojë dhe të ndajë informacion

Përbajtja instruktive – Në programet me cilësi të lartë:

- Shprehitë funksionale targetohen për t'i mësuar me udhëzimet përkatëse
- Udhëzimet ofrohen natyrshëm brenda rutinës së klasës
- Aktivitetet e të mësuarit janë të përshtatshme nga ana zhvillimore
- Ka alternative për aktivitete të ndryshme dhe të shumta që planifikohen për një ditë
- Fëmijët nuk presin që aktivitetet të fillojnë ose të mbarojnë: ka një tranzicion të natyrshëm

Teknikat e dhënies së udhëzimeve – Në programet me cilësi të lartë:

- Stafi reagon pozitivisht ndaj sjelljeve të iniciuara nga fëmijët;
- Stafi përdor strategji të përshtatshme për të lehtësuar praktikën dhe të mësuarit
- Stafi ofron vëmendje të individualizuar gjatë aktiviteteve
- Procedurat për menaxhimin e sjelljes janë të planifikuara dhe përdoren në mënyrë të qendrueshme

Vlerësimi i programit – Në programet me cilësi të lartë:

- Programi ka një plan të shkruar për monitorimin e qëllimeve dhe objektivave;
- Vlerësimi bëhet rregullisht
- Të dhënat përdoren për të marrë vendime për përmirësimin





Aksesi i referohet ofrimit të një rangu të gjerë të mundësive për të mësuar, aktiviteteve, rrethanave dhe mjediseve. **Pjesëmarrja** i referohet ofrimit të pajisjeve dhe materialeve mbështetëse të nevojshme për disa fëmijë, në mënyrë që të mundën të marrin pjesë në aktivitetet mësimore me bashkëmoshatarët dhe të rriturit. **Mbështetja** i referohet krijimit të një infrastrukture mbështetëse, e cila mbështet ofrimin e shërbimeve tërësore për fëmijët dhe familjet.

Cilësitë dhe veçantitë e edukimit tërësor

Një autor tjetër i njohur në fushën e edukimit holistik, Ron Miller (2008)¹², e përkufizon si më poshtë: *Edukimi holistik është një përpjekje për të kultivuar zhvillimin e njeriut në tërësi si qenie njerëzore.* Edukimi tradicional e shikonte fëmijën si një marrës pasiv të informacionit dhe rregullave, ose në rastin më të mirë, një procesues informacioni që i përngjasonte kompjuterit. Përfaqja holistike njih faktin se një fëmijë që rritet për t'u bërë një njeri i plotë duhet të zhvillojë jo vetëm aftësitë intelektuale, por edhe ato fizike, psikologjike, emocionale, ndërpersonale, morale dhe shpirtërore. Fëmija nuk është një punonjës në trajnim, por një qenie e ndjeshme që ka forca jetësore dhe ndikohet nga mjedisi i jashtëm.

Miller identifikoi katër cilësi që karakterizojnë edukimin holistik:

1. *Inkurajon të mësuarit përmes përvojës.* Ka më shumë diskutim, pyetje dhe eksperimentim; ka më shumë angazhim aktiv në një mjedis holistik të të mësuarit dhe një mungesë e testimeve/vlerësimeve, etiketimeve dhe krahasimeve. I mësuarit është proces i rëndësishëm për fëmijët, lidhet me jetën e tyre.
2. *Krijimi i marrëdhënieve personale konsiderohet po aq i rëndësishëm sa dhe arritjet në të mësuar.* Këto mjedise të të mësuarit përqipen të nxisin sensin e komunitetit dhe të përkatësisë, si dhe cilësitë e sigurisë, respektit, përkujdesjes për të tjerët dhe dashurisë.
3. *Theksi vihet dhe në botën e brendshme të fëmijëve; domethënë ka interes dhe për ndjenjat e tyre, aspiratat, idetë dhe pyetjet që çdo fëmijë sjell në procesin e të mësuarit.* Edukimi nuk është më një transmetim informacioni, por një udhëtim vajtje – ardhje në botën e jashtme.
4. *Edukimi holistik shpreh ndërgjegjen “ekologjike”.* Njeh faktin se çdo gjë në botë ekziston në një kontekst të caktuar; në lidhje me komunitetet gjithëpërfshirëse. Kjo përfshin një respekt për natyrën. Është një perspektivë që pranon dhe përqafon diversitetin, si natyror ashtu dhe kulturor.

¹² Kochhar – Bryant, C.A. dhe Heishman, A. (2010). *Effective collaboration for educating the whole child.* Sage publications





O'Hara (2006)¹³shpjegon se qëllimet dhe praktikat aktuale edukative nuk janë gjithmonë të mjaftueshme për të kuptuar ndërlikueshmërinë e botës sonë; nuk përballen me pasigurinë, fleksibilitetin, krijimtarinë, të kuptuarit dhe mençurinë e fëmijëve të shekullit të 21 – të. Në tabelat e mëposhtme mund të shihen dallimet mes një klase tradicionale dhe një nxitëse dhe tërësore në raport me përmbajtjen e programit, rolin e mësuesit dhe përfshirjen e prindërve.

Avantazhet dhe disavantazhet e arsimit gjithëpërfshirës

Arsimi dhe praktikat gjithëpërfshirëse sjellin përfitime për të gjithë.

Për fëmijët e ndryshëm:

- Kanë role – modele që lehtësojnë komunikimin dhe sjelljet social edhe adaptive;
- Mësojnë shprehi motorike, komunikimi dhe të tjera në mjedisë të natyrshme;
- Janë pjesë e mjediseve më stimuluese;
- Marrin një shumëllojshmëri informacionesh, që mund të mos i kishin po të ishin në një klasë më vete;
- Kanë mundësi për të bërë miqësi të reja dhe të ndajnë eksperiencat të reja;
- Kanë sensing e anëtarësisë dhe të përkatësisë në klasë ose në kopsht;
- I ndihmon që të jenë më kreativë duke parë idetë e të tjerëve;

Fëmijë të tjerë:

- Bëhen më pranues ndaj ndryshimeve;
- Ndihen më komfort në praninë dhe shoqërinë e fëmijëve të ndryshëm;
- Përmrësohet vetë – vlerësimi i tyre;
- Kanë një diversitet miqësish;
- Nxitet bashkëpunimi dhe tolerance;

Mësuesit/et:

- Vlerësimi i ndryshimeve mes fëmijëve;
- Akses ndaj specialistëve dhe burimeve për të ndihmuar të gjithë fëmijët;
- Mësojnë teknika të reja për të ndihmuar fëmijët
- Kuptojnë më mirë zhvillimin e fëmijës;
- Punojnë me një grup divers fëmijësh;

13 Po aty





Roli i institucioneve dhe i mësuesve për të krijuar partneritet në mbështetje të prindërve në zhvillimin tërësor të fëmijëve

- Mund të duhet të mësojnë teknika të ndryshme për të çuar informacionin që duan tek të gjithë fëmijët

Prindërit:

- Më të inkurajuar që të marrin pjesë aktivisht në komunitet dhe në kopsht;
- Bëhen të ndëgjegjshëm për diversitetin;
- Njohin më mirë zhvillimin e fëmijëve;
- Mund të marrin më shumë informacione dhe udhëzime.

Disavantazhet e praktikave gjithëpërfshirëse - disa shqetësime në lidhje me gjithëpërfshirjen

- Koha e mësuesve i kushtohet vetëm fëmijëve ndryshe;
- Disa mësues nuk kanë kualifikimet, burimet dhe mbështetjen e duhur për gjithëpërfshirjen;
- Menaxhimi i klasës bëhet më i vështirë;
- Fëmijët e ndryshëm mund të mos ndihen mirë për ndryshimet që kanë.



MATERIAL LEXIMI

RËNDËSIA E KRIJIMIT TË MARRËDHËNIEVE NË FËMIJËRINË E HERSHME

Vitet e para të jetës fëmija ka një progres zhvillimor të jashtëzakonshëm. Gjatë kësaj periudhe, foshnjat zhvillohen nga të porsalindur në fëmijë që mund të ngjisin shkallët, të përdorin gjuhën për të kërkuar gjërat që duan, të kontrollojnë impulset e tyre etj. I mësuari që udhëheq këtë zhvillim të jashtëzakonshëm ndodh kur fëmijët qeshin, rrotullohen, zvarriten dhe eksplorojnë mjediset e tyre, të gjendur në marrëdhënie mbështetëse dhe përkujdesëse.

Për shembull:

- Një foshnjë mëson se e qara e vetë i komunikon së ëmës urinë që ka, në momentin që ajo përgjigjet duke e ushqyer.
- Një fëmijë i vogël mëson të thotë: “Libër” ndërsa përpiqet për të arritur në prehrin e njeriut që kujdeset për të. “Një libër, do që të të lexoj? Le të shohim çfarë kemi sot..”
- Një 2 – vjeçar i ndrojtur mëson se mund të ketë besim në një njeri të panjohur kur shikon mamin e vetë duke buzëqeshur: buzëqeshja i thotë fëmijës që e ëma e njej dhe e pëlqen këtë njeri.

Ashtu siç e tregojnë dhe rastet e mësipërme, ndërveprimet mes fëmijëve dhe përkujdesësve të tyre janë baza e të mësuarit dhe e zhvillimit të tyre. Krijimi i marrëdhënieve fillon që nga momentet e hershme, kur fëmijët mund të ndjejnë ngrohtësinë dhe afrimitetin e të mbajturit “hopa” dhe e të ushqyerit. Me kalimin e kohës marrëdhëniet evoluojnë përmes ndërveprimeve të vazhdueshme mes fëmijës dhe përkujdesësit të vet. Këto marrëdhënie formohen me përkujdesës parësorë të rëndësishëm dhe bëhen konteksti thelbësor i menduarit.

Zhvillimi i hershëm ndodh përmes marrëdhënieve

Zhvillimi në fëmijërinë e hershme dhe në foshnjëri është përkufizuar si transaksional ose si një proces “shërbej dhe rikthej”. Ndërveprimet





mes foshnjës/fëmijës dhe përkujdesësit kanë një impakt të rëndësishëm në zhvillimin e tyre. Një foshnjë që buzëqesh dhe merr kíkílisje si përgjigje, ka marrë një shpërbíbil pozitiv dhe do të buzëqesh përsëri, duke pritur dhe reagime të tjera pozitive nga përkujdesësja. Në të tilla ndërveprime, përkujdesësi dhe fëmija perceptohen si partnerë aktivë në këtë shkëmbim, ndërsa “kërcimi i intimitetit” perceptohet si përforsim reciprok për foshnjën dhe përkujdesësen. Gradualisht, këto ndërveprime ofrojnë komfort dhe parashikueshmëri si për përkujdesësin ashtu dhe për foshnjën, duke formuar bazën e një marrëdhënieje përkujdesi reciprok.

Marrëdhëniet kyçe për fëmijët

- Marrëdhëniet prind/fëmijë

Marrëdhënia prind – fëmijë është thelbësore për zhvillimin e fëmijës. “Edhe në rastet kur foshnjat kalojnë pjesën më të madhe të orëve që janë zgjuar në kopsht/çerdhe, sërish prindërit janë të rriturit më ndikues në jetën e tyre” (National Research Council, 2000)¹⁴. Si nënat dhe baballarët luajnë një rol të rëndësishëm, cilësia emocionale e secilës prej marrëdhënieve ka një ndikim të dallueshëm në zhvillim. Përmes kësaj marrëdhënieje fëmija fillon të kuptojë botën në të gjitha fushat zhvillimore (Parlakian & Seibel, 2002)¹⁵. Përkujdesësit efektivë janë të ndërgjegjshëm dhe vëzhgojnë cilësinë e marrëdhënieve të hershme. Ndonëse është e qartë se kujdesi dhe marrëdhëniet e përgjegjshme janë rruga për një zhvillim të shëndetshëm të fëmijës, ia vlen të shihen faktorët e shumtë që mund të ndikojnë në marrëdhënien prind – fëmijë.

Karakteristikat e fëmijëve, si p.sh. temperamenti ose niveli i angazhimit) kontribuojnë në “kërcimin” mes prindit dhe fëmijës. Përveç karakteristikave të vetë fëmijës një sërë faktorësh që i përkasin prindërve janë po ashtu ndikues. Për shembull, stresi ekonomik ose siguria e familjes, shëndeti mendor i prindërve ose depresioni, konflikti martesor etj. mund të kontribuojnë në aftësinë e prindit për të qenë i përgjegjshëm ndaj fëmijës.

Marrëdhënia përkujdesës/e – fëmijë

Ky informacion paraqet një argument të fortë për rëndësinë e marrëdhënieve që përkujdesësit kanë me fëmijët në kujdesin e tyre. Zhvillimi social dhe emocional që ndodh gjatë ketyre fazave përbën

¹⁴ National Training Institute for Child Care Health (2010). *Relationships, the heart of development and learning*. U.S. Department of Health and Human Services

¹⁵ Po aty





bazën për një pjesë të mirë të zhvillimit të mëvonshëm që fëmija do të përjetojë; ofruesit e kujdesit janë në një pozicion kyç për të ndikuar në këto arritje psikosociale. Mund të jetë e rëndësishme për përkujdesësit të reflektojnë për mënyrën me të cilën ata vetë janë rritur, kanë patur atashime dhe kanë ndërvepruar me të tjerët. Arsyeja qëndron në faktin se shpeshherë përkujdesësit përsëritin modelet e përkujdesjes që ata kanë patur në fëmijërinë e tyre, edhe ato që nuk i kanë pëlqyer kur ishin fëmijë. Reflektimi mund të çojë në ndërgjegjësimit; përkujdesësit ndërgjegjësohen për atë që mund të sjellin në marrëdhëniet e tyre aktuale, duke mbështetur aftësinë për të zgjedhur në mënyrë të ndërgjegjshme ndërveprime pozitive dhe të përgjegjshme si bazën e marrëdhënieve me foshnjat dhe fëmijët në kujdesin e tyre.

Ngaqë ofruesit e kujdesit (mësueset) nuk kanë lidhjen që kanë fëmijët me prindërit e tyre, është shumë e rëndësishme që përkujdesësit të jenë në dijeni për natyrën e marrëdhënies prind – fëmijë. Kjo do të thotë se marrëdhënia është e ndërtuar në një seri ndërveprimesh në të cilat foshnja merr pjesë në një ndërveprim me përkujdesësin, sikurse dhe me prindin, dhe përkujdesësi i përgjegjshëm i përgjigjet.

Në një kopsht ku ka shumë fëmijë dhe ku mësuesët duhet të kujdesen për më disa prej tyre, fëmijët, të cilët janë mësuar të jenë në një marrëdhënie ndërvepruese do të kërkojnë më shumë vëmendje dhe angazhim nga ana e mësueses në raport me ata që nuk janë të prirur për ndërveprim. Fëmijët, të cilët në marrëdhëniet e mëparshme nuk kanë pasur aq shumë ndërveprim presin më pak dhe nga mësueset; me natyrën e tyre jo shumë kërkuese dhe të qetë mund të marrin më pak vëmendje. Mësueset duhet të jenë të ndërgjegjshëm për këtë mundësi dhe të balancojnë vëmendjen e tyre mes të gjithë fëmijëve, për t'u siguruar se të gjithë fëmijët kanë ndërveprime të përgjegjshme që do t'i çojnë në një zhvillim të shëndetshëm.

- **Marrëdhënia prind – mësuese**

Bronfenbrenner (1979)¹⁶ ka identifikuar “ndërlidhjet mes dy ose më shumë mjediseve, në të cilat rritet dhe merr pjesë një fëmijë, si kritike për zhvillimin e fëmijës”. Kjo do të thotë se edhe marrëdhënia mes ofruesit të kujdesit dhe prindit është shumë e rëndësishme për zhvillimin e fëmijës.

Një marrëdhënie pozitive mësuese – prind mund të mundësojë disa procese të rëndësishme:

16 National Training Institute for Child Care Health (2010). *Relationships, the heart of development and learning*. U.S. Department of Health and Human Services





- **Vazhdimësi mes mjediseve të fëmijës:** një rezultat i natyrshëm që vjen nga marrëdhënia pozitive mes prindit dhe mësueses është komunikimi i hapur dhe i vazhdueshëm. Mësueset mund të ndajnë informacionet hapur për ditën e fëmijës me prindin, dhe prindi mund të ndajë informacion për preferencat e fëmijës, arritjet e reja, këshilla për të përballuar situata sfiduese që i kanë rezultuar atij/asaj të suksesshme etj. me mësueset. Ky nivel i komunikimit efektiv mbështet vazhdimësinë në mjediset e ndryshme të fëmijës, dhe e bën botën më të parashikueshme dhe të qëndrueshme. Mungesat e vazhdimësisë gjithashtu mund të jenë të pranishme, si p.sh, në rastin kur një prind shprehet se e qëllon fëmijën në shtëpi si një strategji disiplinimi. Në një marrëdhënie të efektshme prind – mësuese këto komente mund të hapin derën për diskutime të mëtejshme mes këtyre aktorëve, në lidhje me strategjitë e disiplinimit që përdoren në kopsht/çerdhe, për të promovuar përdorimin e praktikave të tjera, pozitive dhe efektive për disiplinimin e fëmijëve.
- **Ndërhyrja e mësueses në marrëdhënie prind – fëmijë.** Marrëdhënia pozitive prind – mësuese lejon që mësuesja të ndërhyjë pozitivisht në këtë marrëdhënie. Kjo nuk do të ishte e mundur nëse marrëdhënia mes prindit dhe mësueses nuk do të ishte pozitive, ose nëse do të ishin të distancuar apo të tensionuar. Mësueset që shqetësohen për zhvillimin e fëmijëve në grupin e tyre janë të hapura dhe i përgjigjen pyetjeve të prindërve për zhvillimin e fëmijës së tyre. Mësueset mund të vëzhgojnë marrëdhënien prind – fëmijë kur prindi është i pranishëm dhe mund të shfrytëzojnë rastin për të mësuar diçka tek prindi në atë moment, në momentin e vëzhgimit të një situatë ku prindi mund të ketë nevojë për mbështetje. Nëse marrëdhënia mes tyre është e mirë atëherë prindi do të jetë i hapur dhe do të kërkojë për këshilla për këtë “edukim informal” nga ana e mësueses.
- **Procesi paralel.** Ndjenjat dhe ndërveprimet nga një marrëdhënie mund të mbarten në një tjetër. Sikurse ndodh në fëmijërinë e hershme ky koncept nënkupton se marrëdhënia mes prindit dhe mësueses mund të ndikojë në marrëdhënien prind – fëmijë. Nëse profesionistët e fëmijërisë së hershme kërkojnë që fëmijët të rriten në marrëdhënie të ngrohta, të shëndetshme dhe efektive prind - fëmijë, atëherë mbase duhe të angazhohen në marrëdhënie të shëndetshme dhe efektive prind – mësuese. Përmes mbështetjes së prindërve në rolin e tyre si përkujdesës, mësueset, përmes procesit paralel, kontribuojnë në mirëqenien e fëmijëve të vegjël.





- **Fuqizimi i familjeve.** Programet e kujdesit të fëmijëve në arsimin parashkollor që zbatojnë strategji të cilat fuqizojnë familjet kanë reduktuar abuzimin e fëmijëve dhe neglizhimin mes familjeve që marrin pjesë në këto programe. Shumë nga këto strategji bazohen në marrëdhënia efektive mes prindërve dhe mësuesve. Për shembull, kërkimet kanë treguar se fuqizimi i prindërve përmes edukimit të tyre, ose demonstrimi i vlerave dhe mbështetjes për familjes rezultojnë në reduktimin e abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve. Këto strategji mund të jenë efektive në një kontekst pozitiv mes prindit dhe mësueses.

- **Marrëdhënia mësuese - mësuese**

Fëmijët janë të ndjeshëm ndaj marrëdhënieve mes njerëzve që janë rreth e qark tyre. Kjo do të thotë se marrëdhëniet mes mësuesve dhe të rriturve të tjerë në kopsht kanë efekt tek fëmijët dhe tek ofrimi i kujdesit në atë mjedis. Një marrëdhënie e lehtë dhe e përgjegjshme mes mësuesve krijon një mjedis të relaksuar dhe emocionalisht të sigurt. Nga ana tjetër, tensioni mes mësuesve ka efekte negative në ofrimin e kujdesit dhe mund të ndikojë në ndjenjën e sigurisë dhe angazhimit që ndjen fëmija.

- **Marrëdhënia të tjera kyçe**

Ka mundësi që në jetën e një fëmijë do të ekzistojnë dhe marrëdhënie të tjera, në varësi të mjedisit të familjes, vlerave dhe prioriteteve. Ky konstelacion marrëdhëniesh kontribuon në kontekstin e zhvillimit të fëmijës. Këto marrëdhënie mund të jenë:

- marrëdhënia me motrat/vëllezërit;
- marrëdhënie me familje të zgjeruar, në varësi të afërsisë dhe shpeshësisë së ndërveprimeve
- marrëdhënie me gjyshërit, veçanërisht me ata që luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e nipërve/mbesave të tyre;
- Marrëdhënie me ofrues të tjerë të shërbimeve (p.sh., nëse fëmija ka një nevojë të veçantë); dhe
- Marrëdhënia me bashkëmoshatarët në mjedisin e kopshtit/çerdhes





Seancë

USHTRIM



MITE PËR PËRFSHIRJEN E PRINDËRVE

Qëllimet

- Nxitja e të menduarit për përfshirjen në arsimin parashkollor
- Ndërgjegjësimi për anët pozitive të përfshirjes së prindërve

Koha

15 minuta

Metoda

Diskutim në grup

Hapat

1. Trajneri i fton pjesëmarrësit të japin mendimin e tyre për pohimet e mëposhtme :

Miti 1: Prindërit dhe familjet që jetojnë në kushte të vështira socio – ekonomike janë më pak të interesuar dhe më pak të aftë për të mbështetur fëmijën e tyre.

Miti 2: Mënyra më e mirë që prindërit të marrin pjesë në arsimin parashkollor të fëmijëve të tyre është përmes programeve të prindërimit.

Miti 3: Kopshtet dhe mësueset kanë ndikimin më të madh në procesin e të mësuarit të fëmijës.

Miti 4: Përfshirja e prindërve dhe angazhimi i familjes janë pritshmëri që thjesht shtojnë kohën dhe përpjekjen në një stad mësuesesh të mbingarkuara, ndërkohë që nuk ka asnjë përfitim nga kjo përfshirje.

2. Diskutohet në grup të madh për përgjigjet e prindërve.

Mjete pune

Flipçarte, markera, stilolapsa.



MATERIALE LEXIMI

BASHKËPUNIMI PRINDËR - MËSUESE

Epstein et al. (1996)¹⁷ kanë propozuar një kuadër të përfshirjes prindërore që përmban gjashtë tipe aktivitete që lidhin familjet, kopshtet dhe komunitetet:

Prindërimi: familjet janë për të ofruar kujdes për shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve të tyre, për të krijuar një mjedis në shtëpi që inkurajon të mësuarin dhe sjelljen e mirë në mjedisin e kopshtit; kopshtet duhet të ofrojnë informacione për të ndihmuar prindërit të kuptojnë dhe të nxisin zhvillimin e fëmijëve të tyre;

Komunikimi: institucionet e arsimit parashkollor duhet të jenë përgjegjës për të ofruar informacion në lidhje me ecurinë e fëmijës; mjetet e komunikimit që përdorin duhet të jenë të përshtatshme për prindërit për specifikat e tyre, ndërsa ky proces duhet të jetë dydrejtimsh;

Vullnetarizmi: prindërit mund të kontribuojnë shumë në mjedisin dhe funksionin e kopshtit; kopshtet dhe çerdhet mund të përfitojnë shumë nga ky proces duke ofruar orare fleksible për prindërit – vullnetarë, në mënyrë që të marrin pjesë sa më shumë prej tyre, dhe duke punuar për të përputhur talentet dhe interesat e prindërve për nevojat e fëmijëve dhe mësuesëve.

Të mësuarit në shtëpi: prindërit mund të ndihmojnë fëmijët e tyre për “detyrat” që kanë për kopshtin, ose mund të përsërisin disa nga mësimet që të kuptohen më mirë nga fëmijët. Kjo mund të ndodhë me udhëzimet përkatëse nga mësueset;

Vendim - marrja: kopshtet mund t’i japin prindërve role të rëndësishme në institucion dhe në procesin e vendimmarrjes; kjo mundësi duhet të jetë e hapur për të gjithë prindërit dhe njerëzit e një komuniteti, jo vetëm për ata që kanë më shumë kohë dhe energji për t’u marrë me këtë angazhim.

Bashkëpunimi me komunitetin: kopshtet duhet të koordinojnë punën e tyre dhe me burimet e komunitetit, të bizneseve dhe grupeve

¹⁷ Petrovic, M. (2009). Literature review: Family – school partnership models. E marrë nga <http://www.see-educoop.net/aeiq/documents/v02%20The%20effects%20of%20parent%20involvement%20in%20schools.pdf> e aksesuar në Shtator 2014





të tjera për të fuqizuar programet e tyre, praktikat në familje dhe të mësuarit dhe zhvillimit; kopshtet mund të ndihmojnë prindërit për të pasur më shumë akses në shërbimet mbështetëse nga institucione të tjera, si shëndetësore, ngjarje kulturore dhe programe pas shkolle.

Si mund të mësoj për ecurinë e fëmijës sim në kopsht?

Ekzistojnë disa mënyra si mund të informoheni nga mësuesja për përparimin e fëmijës suaj si dhe për programin që ndjek kopshti, p.sh.:

- Mbledhjet periodike të prindërve në ambientin e kopshtit, ku bashkëbisedohen tema rreth funksionit dhe programit të kopshtit.
- Konsultime të shkurtra të përditshme me mësuesen, kur prindërit sjellin ose marrin fëmijët e tyre nga kopshti.
- Takime të posaçme individuale të prindërve me mësuesen, ku u jepet mundësia të bisedojnë sëbashku çështje që kanë të bëjnë me fëmijën e tyre.
- Kontakte telefonike me mësuesen/in në telefonin e kopshtit, kur ekziston ndonjë arsye konkrete.
- Takime informuese me specialistë në fushën e arsimit parashkollor, në të cilat bisedohen temat që u interesojnë prindërve. Përveç rasteve që përmenden më lart, sigurisht, keni gjithmonë mundësinë të bisedoni me mësuesen, për çdo nevojë urgjente.

Si mund të marr pjesë në aktivitetet e kopshtit?

Bashkëpunimi midis kopshtit dhe familjes ka shumë dobi për fëmijët. Më e rëndësishmja është se krijon një vijim për gjithçka ndodh midis dy ambienteve ku jeton, vepron dhe mëson çdo ditë fëmija. Gjatë vitit shkollor fëmijët kanë nevojë për ndihmën tuaj. Për shembull, mund të sillni në kopsht disa objekte, libra ose informacione nga shtëpia, që kanë të bëjnë me tema që u interesojnë fëmijëve dhe me të cilat merren atë periudhë në kopsht. Gjithashtu, në bashkëpunim me mësuesin/en, mund të merrni pjesë në disa veprimtari të kopshtit, të ndihmoni në një aktivitet ose të ofroni dijet dhe eksperiencat tuaja rreth çështjeve të ndryshme, etj.

Çfarë mund të bëj që të ndihmoj fëmijën tim në shtëpi?

Është e rëndësishme që përpjekja që bëhet në kopsht të përkrahet dhe të fuqizohet nga shtëpia.

Loja është mënyra më fuqishme dhe më rezultative e të mësuarit për fëmijën e cila e ndihmon të njohë më mirë botën rreth tij. Është themelore, të keni gjithmonë parasysh nevojën e fëmijës për lojë dhe





të përdorni raste që e fuqizojnë atë. Mirë është të krijoni vend dhe të lini kohë për lojë, të luani bashkë me fëmijën tuaj, ta sillni në kontakt me moshatarë, etj. Sidomos kontakti dhe loja me fëmijë të tjerë ndihmon në socializimin e tij sepse mëson të ndajë, të dëgjojë dhe të respektojë nevojat e të tjerëve. Gjithashtu mund të shfrytëzoni momente të përditshme që të përfshini fëmijët në aktivitete zbatimëse, por dhe mësimdhënëse, si: gatimi dhe blerja në super market, ku fëmija vjen në kontakt me shkronjat, numrat dhe informacionet sociale të nevojshme.

Bashkëpunimi prindër – mësuese është një kusht i domosdoshëm gjatë procesit të rritjes, edukimit të fëmijëve.

- A. Prindërit kanë nevojë të ndiejnë mbështetjen e mësueseve; ata duhet të informohen mbi gjithçka që lidhet me fëmijën
- B. Mësueset duhet t'u përgjigjen nevojave të prindërve për të qenë të informuar lidhur me çdo gjë që ka të bëjë me fëmijën e tyre.
- C. Prindërit duhet të dëgohen me shumë kujdes dhe vëmendje, pasi ata e njohin fëmijën e tyre më mirë se kushdo tjetër dhe përbëjnë një burim të çmuar informacioni.
- D. Prania dhe pjesëmarrja e prindërve në aktivitetet mësimore duhet nxitur dhe inkurajuar.
- E. Mësueset duhet të diskutojnë me prindërit për shumëllojshmërinë e aktiviteteve që fëmija duhet të kryejë në familje.
- F. Prindërit, në ditë të caktuara, mund të vijnë më herët në kopsht për të parë se si fëmijët e tyre përfshihen në aktivitete, se si ata zbatojnë rregullat, se si luajnë dhe përfshihen në aktivitete
- G. Prindërit nuk duhet të jenë shumë kërkues, qortues e korrigjues ndaj fëmijëve.
- H. Mësueset duhet t'u tregojnë prindërve se çfarë kanë bërë fëmijët e tyre, se cili është progresi i tyre dhe vështirësitë me të cilat ata ndeshen.

Pjesëmarrja e prindërve në aktivitete praktike

- Prindërit dhe mësueset duhet të ndajnë me njëri-tjetrin çdo etapë të rritjes, zhvillimit, edukimit dhe ndërhyrjeve tek fëmijët.
- Mësueset duhet t'u përcjellin prindërve qetësinë, besimin dhe sigurinë se fëmijët e tyre janë në duar të sigurta.
- Ndërmjet familjes dhe institucionit arsimor nuk duhet të ketë korniza, duhet të ketë aftësi të mira dialogu dhe mirëkuptim reciprok.





- Prindërit ndonjëherë shfaqin qëndrime tepër mbrojtëse ndaj fëmijëve, duke i penguar ata të krijojnë disa eksperiencë të domosdoshme për të zhvilluar aftësitë e tyre.
- Shpesh, prindërit i projektojnë në mënyrë subjektive fëmijët e tyre.
- Është e nevojshme që, brenda kopshtit, prindërve t'u krijohet një mjedis ku ata të mund të flasin për të gjitha shqetësimet, nevojat, problemet dhe dëshirat që kanë lidhur me fëmijët e tyre. Ata duhet të ndajnë me njëri-tjetrin përjetimet dhe eksperiencat e të mësojnë nga përvoja dhe praktika të suksesshme.
- Prindërit duhet të përfshihen fillimisht në aktivitete me karakter social-edukativ si p.sh. ekskursione, shëtitje, ekspozita pikturë, vajtje në cirk, në kinema etj.
- Më pas, prindërit duhet të përfshihen në jetën e kopshtit si asistentë: të marrin pjesë në aktivitete mësimore; të vëzhgojnë se ç'ndodh brenda klasës; të vëzhgojnë mënyrat se si fëmija përfshihet, si i merr dhe si i zbaton instruksionet.
- Prindërit mund të ndahen në grupe për t'i shërbyer më mirë fëmijës dhe për të bashkëpunuar më nga afër me mësueset.
- Familja dhe kopshti nuk mund të realizojnë misionin e tyre pa siguruar një bashkëpunim të plotë e të suksesshëm me njëri-tjetrin.
- Por, prindërit duhet të përfshihen edhe në vendimmarrje brenda institucionit parashkollor, për çdo vendim apo proces që lidhet në mënyrë direkte apo indirekte me fëmijët e tyre.

Bashkëpunimi i kopshtit me familjen kontribuon në zhvillimin më të mirë të fëmijës. Është shumë e rëndësishme për fëmijën të shikojë dhe të ndjejë se kopshti dhe shtëpia kanë marrëdhënie harmonike. Në këtë mënyrë ndihet më i sigurtë, gjë e cila jep rezultate më të mira në zhvillimin e tij. Prindërit janë personat më të rëndësishëm në jetën e një fëmije, prandaj dhe pjesëmarrja e tyre në procedurën mësimore të fëmijës është e domosdoshme.





USHTRIM



TIPET E BASHKËPUNIMIT

Qëllimet

- Nxitja e të menduarit për tipet e ndryshme të bashkëpunimit
- Ndërgjegjësimi për anët pozitive dhe negative të secilit tip.

Koha

10 minuta

Metoda

Diskutim në grup

Hapat

- Trajneri/ja i bën pjesëmarrësve pyetjet e mëposhtme, pasi ka prezantuar materialin e leximit “Bashkëpunimi prindër – mësuese”
 - Cilin nga këto tipe të pjesëmarrjes e konsideroni si më të kënaqshëm dhe pse? (në grupe prej 3 – 5 personash)?
 - Për cilin nga këto tipe të pjesëmarrjes do të donit të kishit më shumë informacion? (p.sh. Prindërimi: përdorimi i kompjuterit nga fëmijët? Të mësuarit në shtëpi?). Përpiquni të jeni specifikë.





Seancë USHTRIM



REFLEKTIM PËR BASHKËPUNIMIN

Qëllimet

- Nxitja e të menduarit për fëmijërinë e prindërve
- Ndërgjegjësimi për anët pozitive të përfshirjes në arsimin parashkollor

Koha

15 minuta

Metoda

Diskutim në grup

Hapat

1. Trajneri i bën pjesëmarrësve pyetjet e mëposhtme:
 - Kur mendoni për t'u përfshirë në kopsht, pyeteni veten:
 - Si ndihesha unë në kopsht?
 - A ishin prindërit e mi të përfshirë në edukimin tim?
 - A ishin prindërit e tjerë të përfshirë në edukimin e fëmijëve të tyre kur unë isha fëmijë?
 - A kishte ndryshime mes fëmijëve, prindërit e të cilëve ishin të përfshirë dhe atyre që nuk ishin? Nës epo, çfarë?
 - A e çoj fëmijën në kopsht të pastër, të shplodhur dhe të ushqyer?
 - Çfarë do të thotë të jesh prind në kopshtin e fëmijës sim? A i kam ndarë ndjenjat e mia me stafin?

Pastaj mendoni për pyetjet:

- Cila është gjendja e kopshtit? A mund të ndihmoj unë?
 - Çfarë preferoj më shumë të bëj? A mund ta bëj këtë me fëmijët?
2. Diskutohet në grup të madh



MATERIAL LEXIMI

MARRËDHËNIET PRINDËR – MËSUESE NË MBËSHTETJE TË GJITHËPËRFSHIRJES DHE EDUKIMIT TËRËSOR

Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e një marrëdhënie efektive

Ka një numër faktorësh që ndikojnë aftësinë e të dyja palëve për të ndërtuar një marrëdhënie optimale. Në këta faktorë përfshihen:

- Kultura dhe vlerat e mësueseve dhe prindërve
- Kuptimi i roleve të mësueseve dhe prindërve
- Ndjenja e efikasitetit personal të mësueseve dhe prindërve
- Karakteristikat personale të mësueseve dhe mësueseve
- Pritshmëritë e mësueseve dhe prindërve
- Aftësitë e komunikimit të mësueseve dhe prindërve
- Njohuritë e mësueseve dhe prindërve për fëmijët
- Njohuritë dhe aftësitë profesionale të mësueseve

Si mund të përmirësohet marrëdhënia prind – mësuese?

Aftësitë komunikuese ndërmjet prindërve dhe mësueseve duhet të përmirësohen së pari përmes komunikimit. Si prindërit, ashtu edhe mësueset duhet të mësojnë t'ua komunikojnë nevojat apo kërkesat e tyre e tyre njëri – tjetrit përmes mënyrave efektive të komunikimit. Ata duhet të shprehin ndjenjat, emocionet, dëshirat në mënyrën e duhur. Fëmija duhet të ketë si në familje dhe në kopsht/shkollë një mjedis të sigurt, të qetë, edukues në të gjithë komponentët e tij.

Shpesh, që të rregullohen këto marrëdhënie është e nevojshme të shfrytëzohen edhe burime të tjera. psikologët, punonjësit socialë, prindërit e fëmijëve të tjerë, kolegë të mësueseve etj.

Për mësueset duhet të jetë e qartë se: Nuk ka prindër të mirë dhe prindër të këqinj, por disa prindër dështojnë në përvetësimin dhe aplikimin e aftësive për të qënë prindër të mirë që do të thotë:

Nuk arrijnë të njohin siç duhet nevojat emocionale të fëmijës, sikurse njohin dhe nevojat e tjera, e si rezultat nuk arrijnë as t'i





plotësojnë këto nevoja. Duke mos i njohur dot këto nevoja, prindërit e kanë të vështirë t'ua transmetojnë ato mësueseve të fëmijës.

Ndonjëherë prindërit bëjnë përshkrime apo përcaktime të papërshtatshme të përgjegjësive të tyre dhe të institucionit arsimor, në lidhje me fëmijët e tyre.

Shpesh fajësohen të tjerët për gabimet e tyre, për neglizhencat, pakujdesitë dhe bëhet i vështirë kapërcimi i problemeve apo vështirësive, duke u dëmtuar kështu marrëdhënia prind – mësuese.

Prindërit e kanë të vështirë të analizojnë dhe të marrin në konsideratë pasojat e mëvonshme të sjelljeve negative tek fëmijët, pasi për ata fëmija është pasqyra e tyre, prandaj konfliktohen me mësuesen kur ato tregojnë për ndikimin që mund të kenë këto sjellje në jetën e mëvonshme të fëmijës.

Tek fëmijët disa probleme në sjelljen e tyre lindin edhe si rezultat i mospërshtatjes me ambientin fizik dhe psikologjik të kopshtit/shkollës. Si rezultat i kësaj mospërshtatje që kërkon ndërhyrje për t'u kapërcyer fëmijët mund të tërhiqen nga jeta e grupit, të mos shfaqin inisiativa, të jenë pasiv për një periudhë të shkurtër kohe. Prindërit e kanë të vështirë të kuptojnë këtë ndryshim të fëmijës së tyre dhe mendojnë se problemi i vetëm është marrëdhënie e fëmijëve me mësueset.

Në përgjithësi prindërit presin të kenë një fëmijë dinamik, të motivuar, që është gjithmonë gati të përfshihet në eksperiencat e reja. Nëse atyre mësuesja ju zbulon të kundërtën, pra që kanë një fëmijë të ndrojtur, hezitues, që nuk ka dëshirë të përfshihet, ata mund ta vënë fëmijën nën një presion duke i kërkuar të jetë ai që nuk mund të jetë në realitet dhe të ndërtojnë një marrëdhënie joefektive me mësuesen.

Prindërit zakonisht krenohen me fëmijët e tyre, flasin për aftësi dhe talente të veçanta. Nuk rreshtin së treguari mësueseve detaje nga moshat e foshnjërisë, ku fëmija në ndryshim nga bashkëmohatarët e tij ka qënë një gjeni. Por kur mësuesja nuk ndan me tat ë njëjat konstatime dhe kur pritshmëritë e tyre nga kopshti/shkolla nuk përputhen, atëherë ata përpiqen ta projektojnë gabimin tek mësuesja, tek mësimdhënia, tek sjellja dhe qëndrimi i tyre

Nëse fëmija vjen nga një lidhje shumë e sigurtë në familjen e tij dhe nuk gjen të njëjtën lidhje në kopësht/shkollë krijohen shumë vështirësi, të cilat shprehen më shumë në procesin e të nxënies dhe në sjelljen e fëmijës e më pas këto reflektohen edhe në marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe mësueseve

Motivimi i fëmijës për të nxënë ndikohet shumë edhe nga familja, nga pritshmëritë që kanë prindërit për të, por kur këto pritshmëri janë tepër të larta. ose të ulta ndodh e kundërta.





Fëmija ka nevojë të trajtohet qetësisht, të jetë nën një përkujdesje të vazhdueshme, nuk duhet harruar që për disa fëmijë ambjenti i institucionit arsimor mund të jetë vëndi më i qëndrueshëm, që i jep më shumë siguri.

Barrierat në marrëdhëniet pozitive familje – mësuese

Një numër faktorësh duhet të adresohet në mënyrë që partneriteti familja – mësuese të formohet. Disa nga pengesat më të shpeshta në krijimin e këtij partneriteti janë:

- **Ndryshime në origjinën.** Familja dhe mësuesja vijnë nga kultura, gjuhë dhe status socio – ekonomik të ndryshëm.
- **Stresi.** Stresi ekziston si për familjet ashtu dhe për mësueset. Për shembul, oraret e zgjatura në punë dhe fleksibiliteti i ulët në punë i redukton orët që mësueset të punojnë në komunikimin me familjen dhe për prindërit/përkujdesësit të krijojnë marrëdhënie me të tjerët në kopsht/çerdhe.
 - **Vlera të ndryshme.** Familja dhe mësuesja kanë tërësi vlerash të ndryshme.
 - **Ndryshime në perceptimin e roleve.** Ndryshime në perceptimin e roleve të institucionit parashkollor për fëmijën nga ana e eduktores dhe e prindit ose përkujdesësit.
 - **Tipet e përvojave.** Përvojat e mëparshme me familjet/mësueset përcaktojnë pritshmëri të ndryshme.
 - **Koncepti i të qenit i hapur.** Mungesa e hapjes ndaj njerëzve të jashtëm që hyjnë në territorin e tyre (shtëpia ose kopshti/çerdhja).
 - **Ndryshime në përvoja.** Përvojat e prindit në kopsht/çerdhe (pozitive ose negative) përcaktojnë disa pritshmëri për ndërveprimet e tyre me mësuesen për fëmijën e tyre.
 - **Aftësi komunikuese.** Mësueset ose familjet nuk mund të identifikojnë dhe komunikojnë eksperiencat kyçe, ide ose çështje.
 - **Diskomfort në komunikim.** Familjet ose mësueset nuk ndihen mirë me aftësitë e tyre komunikuese ose nuk zotërojnë mirë gjuhën.
 - **Nevoja për t'u ndjerë i vlerësuar.** Prindërit ose mësueset perceptojnë se perspektiva e tyre nuk respektohet ose nuk merret parasysh.
 - **Ndryshime në perceptimin e nevojave të fëmijës.** Institucioni parashkollor e shikon fëmijën (të mësuarit dhe zhvillimin) ndryshe nga ç'e sheh familja. Filozofia e institucionit






Roli i institucioneve dhe i mësuesve për të krijuar partneritet në mbështetje të prindërve në zhvillimin tërësor të fëmijëve

ndryshon nga ajo e familjes për rritjen e përshtatshme të fëmijës. Për shembull, familja barazon mësimdhënien me të thënit, ndërsa mësuesja mendon se mësimi bëhet duke bërë. Ose problemet e sjellje menaxhohen ndryshe në shtëpi dhe ndryshe në institucion (në shtëpi e qëllonjë në kopsht i shpjegojnë). Kur institucioni parashkollor shpjegon qartë filozofinë e vetë, familjet kanë një kuptim më të mirë për përputhjen e pritshmërive shtëpi – institucion.

Bashkëpunimi mund të përshtatet në përputhje me:

- Kushtet specifike në familje dhe faktorët demografikë;
- Nevojat zhvillimore të fëmijës
- Struktura e institucionit parashkollor
- Burimet e komunitetit



MATERIAL LEXIMI

BARRIERAT NË PJESËMARRJEN E PRINDËRVE

Familjet që janë të përfshira në jetën e fëmijës në institucionet parashkollore në çdo nivel kanë mundësinë të mësojnë më shumë për fëmijën e tyre, si mëson dhe si mund të mbështesin suksesin e fëmijës në kopsht/çerdhe dhe jashtë tyre. Anëtarët e familjes, nga ana tjetër, kanë mundësinë të ndajnë informacionin e tyre në mënyrë që mësueset dhe profesionistët e tjerë mund të kuptojnë më mirë se çfarë strategjish mund të jenë më të suksesshme me fëmijën. Ky shkëmbim informacioni ofron një panoramë më të përgjithshme të fëmijës dhe një mënyrë për të ofruar informacion dhe shërbime që përmbushin nevojat e të gjithë familjes.

Familjet që janë më shumë të përfshira në jetën e fëmijës në kopsht mësojnë më shumë për mënyrën e funksionimit të kopsht dhe kuptojnë më shumë rreth mundësive dhe opsioneve të disponueshme në kopsht, në komunitet dhe në lidhje me aktivitete të tjera. Për më tepër, familjet e përfshira në arsimimin deri në gjimnaz, zakonisht janë më mbështetëse për fëmijët e tyre dhe kanë më shumë besim tek aftësitë e tyre prindërore dhe aftësinë për të ndihmuar fëmijët e tyre për të mësuar. Së fundmi, familjet që janë më shumë të përfshira zakonisht i shohin mësueset dhe kopshtin dhe anëtarët e komunitetit më pozitivisht. Nëse ka ndryshime në mendime ose konflikte, familjet që njohin mësueset në kopsht janë më të gatshme për të diskutuar, për të ndërmjetësuar dhe për të bërë thjesht një ankesë në një institucion më të lartë. Morali i mësueseve është më i lartë kur prindërit janë të përfshirë, sepse përgjithësisht të dyja palët priren të mendojnë më pozitivisht për njëra – tjetrën kur njihen dhe kuptojnë vështirësitë e mësimdhënies ose të prindërimit.

Cilat janë disa nga barrierat në pjesëmarrjen e prindërve?

Jemi të sigurtë se secili prind do të kontribuojë që kopshti i fëmijës se tij të bëhet më i mirë, lagja të jetë më e sigurt dhe të ofrojë mundësi për fëmijët. Në disa komunitete ekzistojnë probleme të shumta dhe





prindërit nuk dinë nga të fillojnë me zgjidhjen e këtyre problemeve. Por, më e rëndësishmja është dëshira për të bërë ndryshime. Gjithsesi, vetë dëshira nuk është e mjaftueshme për të arritur rezultatet. Hulumtimet kanë treguar se shkollat dhe familjet duhet të ndërtojnë marrëdhënie partneriteti të bazuara në komunikimin e ndërsjelltë, në detyrimet dhe përgjegjësitë e përbashkëta gjatë edukimit dhe arsimimit të fëmijëve dhe gjatë organizimit të jetës parashkollore.

Kudo në botë, për pyetjen pse nuk ndërmerren veprime, përgjigjet dhe justifikimet janë të njëjta:

- Prindërit janë të zënë.
- Prindërit kanë frikë të flasin.
- Nuk kemi shembuj nga e kaluara, të cilët mund t'i ndjekim.
- Mosnjohje e praktikës së mirë.
- Nuk besohet se gjërat mund të përmirësohen.
- Nuk dihen aq sa duhet të drejtat personale.
- Mosnjohje e mjaftueshme të të drejtave të veta.
- Nuk ndihen të mirëpritur
- Kanë problem me transportin
- Kanë vështirësi me gjuhën ose kultura të ndryshme

Këshilla për prindërit. Bëni listë me nevojat e kopshtit. Shkruani dëshirat tuaja për një komunitet më të mirë. Mendoni për kopshtin e fëmijëve tuaj, duke filluar prej cilësisë së arsimimit deri te numri i fëmijëve në një klasë. Përfytyroni një kopsht ideal për ju dhe fëmijën tuaj.

Shembuj i një liste me nevoja dhe ndryshime:

Terreni për fëmijët është plot plehra ose xhama të thyer.

- Prindërit duan mjedis më të pastër dhe më të sigurt në të cilin fëmijët mund të luajnë.
- Ushqimi në kopsht nuk i ka vlerat ushqyese të cilat janë të nevojshme për fëmijët.
- Në kopsht nuk ka lodra.
- Nuk ka oborr për të dalë jashtë.
- Fëmijët janë në rrezik për shkak se rruga në të cilën ndodhet kopshtu është ngarkuar me trafik dhe zhurmë shumë shpesh.

Çfarë është partneriteti mes prindërve dhe profesionistëve? Partneriteti, bashkëpunimi dhe integrimi janë fjalë të reja që adresojnë marrëdhëniet mes familjeve dhe atyre që ofrojnë burime, shërbime dhe mbështetje. Në mënyrë që të ekzistojë një marrëdhënie bashkëpunuese familjet dhe profesionistët duhet të vlerësojnë kontributin e secilës palë. Familjet duhet të shihen si partner





që informojnë dhe ndihmojnë mësueset për të kuptuar fëmijëne tyre dhe familjen, fuqitë dhe nevojat që kanë.

Profesionistët sjellin një sërë njohurish specifike për fëmijën. Kanë akses tek bashkëmohatarët që sjellin burime shtesë dhe mundësi për familjet. ata kanë eksperiencë të çmuar dhe njohje për çdo fëmijë, që fitohet në një mjedis jo – shtëpi, dhe ky informacion mund të jetë shumë i rëndësishëm për prindërit. Gjithmonë e më shumë profesionistë pranojnë se në mënyrë që të ketë bashkëpunim, duhet të ndodh një ndryshim në të menduar. Ata nuk mund ta shohin veten si ekspertë ose si “ofruer” shërbimesh, por më shumë si një dëgjues dhe krijues urash – lidhëse.



MATERIAL LEXIMI

PJESËMARRJA PËRMES KOMUNIKIMIT PRINDËR - MËSUESE

Metoda të vlefshme komunikimi

Berger (2000)¹⁸ ka përshkruar dy kategori të mëdha të komunikimit mes mësueseve dhe familjeve: komunikimin dydrejtimsh dhe atë njëdrejtimsh. Komunikimi dydrejtimsh ndodh kur ka ndërveprime mes prindërve dhe mësueseve që shkojnë në të dyja drejtimet. Komunikimi njëdrejtimsh ndodh kur kopshti informon familjen për diçka.

Komunikimi dydrejtimsh

Ndërveprimet mes kopshtit dhe familjeve duhet të jenë të vazhdueshme. Ndërveprimet më të rëndësishme janë ato që shkojnë në të dyja drejtimet – mësueset mësojnë nga prindërit dhe prindërit nga mësueset (Galinsky, 1989)¹⁹. Këto ndërveprime dy – drejtimsh janë të arsyeshme, sepse mësueset dhe prindërit duhet të punojnë së bashku për interesin më të madhe të fëmijës.

Kur përfshihet një komunikim dydrejtimsh në programin e kopshtit, është e rëndësishme të mbahet mend se jo të gjithë prindërit mund të vijnë në kopsht në kohën e përcaktuar për takimin. Një nënë ose një baba, p.sh., mund të kenë vështirësi për të marrë leje nga puna ose mund të mos kenë transport për të bërë një vizitë në mes të ditës. Është e rëndësishme që takimet prindër – mësuese dhe aktivitetet e tjera të rëndësishme të kenë fleksibilitet. Prindërit kujdesen për fëmijët e tyre dhe zakonisht duan të marrin pjesë në edukimin e tyre. Ata mbase kanë nevojë që IP të akomodojë pak më shumë nevojat e tyre. Bërja e sondazhit tek prindërit mund të jetë shumë e vlefshme për të marrë informacion në lidhje me takimet dhe me llojet e takimeve që i gjykojnë si të dobishme. Prania e prindërve është më e lartë kur mësueset i dëgjojnë prindërit dhe planifikojnë ngjarje sipas informacionit të marrë

18 Berger, E. (2000). *Parents as partners in education*. NJ: Merrill Publishing Company

19 Galinsky, E. (1989). From our president. A parent/teacher study: Interesting results. *Young Children*, 45(1): 2-3.





në sondazh. Tipet e ndryshme të komunikimit të dyanshëm që mësueset gjejnë ndihmues janë²⁰:

1. **Email/Facebook.** Nëse prindërit dhe mësueset kanë akses në një kompjuter, e – maili mund të jetë një mënyrë e shpejtë dhe e lehtë komunikimi.
2. **Diskutime në telefon.** Kur një mësuese merr në telefon prindërit ata automatikisht mendojnë se janë lajme negative. Është mirë që mësueset të gjejnë kohën për të telefonuar dhe për lajme të mira për çdo fëmijë, veçanërisht në muajt e parë në kopsht.
3. **Lënia e mesazheve.** Prindërit duhet të dinë se mund të marrin në telefon dhe të lënë mesazhe për mësuesen e tyre. Ata duhet të lënë një afat për marrjen e përgjigjes: p.sh, emergjencë ose jo, për ta bërë më të qartë.
4. **Vizita personale.** Ndonjëherë është ndihmuese nëse i bëhet një vizitë familjes në shtëpi. Megjithatë, është e rëndësishme që t'i thuhet familjeve qëllim i vizitës. Për ata prindër që nuk duan të kenë mësuesen në shtëpinë e tyre mund të propozoni mjedise të tjera për këto vizita si p.sh. një park lodrash, një kafe, shtëpia e gjyshërve etj.
5. **Vizita në grup.** Bërja e vizitave në shtëpi ose në punë i jep përshtypjen prindërve se njohja e familjeve është e rëndësishme për mësuesen, kopshtin dhe fëmijët e tjerë. Përpyekja e vizitës zakonisht shpërblehet me ndjenja pozitive për kopshtin dhe ndjenja pozitive tek fëmija për familjen e tij/saj.
6. **Mundësi për anëtarët e familjes që të jenë pjesë e klasës.** Vullnetarët dhe vizitorët në klasë ndërtojnë një sens komuniteti. Kur praktikohet kjo metodë, është e rëndësishme që mësueset të komunikojnë pritshmëritë para vizitës duke dhënë ftesa specifike si p.sh. ofrimi i mundësisë tek prindërit për të ngrënë bashkë me fëmijën e tyre drekën.
7. **Ngjarje sociale.** Ftoni familjet dhe stafin e kopshtit në një ngjarje sociale si p.sh. në një mëngjes. Ofrimi i ushqimit dhe kujdesi për fëmijën nxitin frekuentimin, pasi kjo e bën ngjarjen më pak detyruese për prindërit. Mësueset duhet të kërkojnë për mënyra krijuese për ta bërë ngjarjen sa më pozitive që të jetë e mundur.
8. **Takimet prind - mësuese.** Laëler (1991)²¹ ofron këshilla për mësueset për të përballuar situata të ndryshme, tipe

20 Klein, S. dhe Marian Miller, M. In Support of Family-Teacher Partnerships. E marrë nga http://www.earlychildhoodnews.com/earlychildhood/article_view.aspx?ArticleID=359 e aksesuar në Shtator 2014

21 Po aty





të ndryshme familjesh dhe modele të ndryshme për këto takime. Tradicionalisht, këto takime konsistojnë në dhënien e informacionit nga mësuesja për ecurinë e fëmijës në kopsht. Është e rëndësishme që në këto takime të dëgjojen dhe shqetësimet e prindërve.

Komunikimi njëdrejtimsh

Edhe pse komunikimi dydrejtimsh është thelbësor, nga ana tjetër edhe ai njëdrejtimsh mund të luajë një rol të rëndësishëm. Prindërit janë shumë të interesuar kur dëgjojnë se çfarë ndodh në kopsht, edhe në rastet kur ky komunikim është njëdrejtimsh. Gëzimi i prindërve për të mësuar për aktivitetet në klasë është komunikuar qartë nga një prind me fëmijë në kopsht, e cila iu referua letrës informuese të parë që mori nga kopshti i saj si një “minierë me flori”. Komunikimi i menduar ndihmon prindërit të dinë se cilat janë pritshmëritë e kopshtit dhe i jep një ide për atë që ndodh në klasën e fëmijëve të tyre. Për rrjedhojë, klasa nuk është një pjesë e ndarë nga jeta e fëmijës së vet. Mënyrat e mëposhtme të një komunikimi efektiv janë ofruar nga Berger (2000)²²:

1. **Letra informuese (Neësletter).** Letrat informuese mund të përfshijnë çështje si thënie nga fëmijët, punime të tyre, sugjerime për libra për familjen, fjalë – këngë ose lojëra, fotografi që tregojnë se çfarë janë duke bërë fëmijët e tyre, receta, kalendarë etj.
2. **Dokumente.** Prindërit duhet të kenë një kopje të politikave të kopshtit. Duke i pasur këto në gjuhën e përshtatshme për prindërit dhe familjet (ose edhe të inçizuara) i ndihmon ata për të reduktuar keqkuptimet, si p.sh. për rastin kur fëmijët janë të sëmurë për të frekuentuar kopshtin dhe arsytet pse.
3. **Tabela e familjes.** Mësueset mund të përdorin tabela të buta për të vendosur fotografi që kanë ndodhur gjatë ditës. Shembuj të tjerë janë fotografitë e të gjithë fëmijëve dhe mbase të familjeve të tyre ose shfaqje që janë bashkë fëmijët dhe mësueset.
4. **Shënime.** Shënimet nga mësuesja mund të jenë formale dhe joformale. P.sh. pse të mos çohen në shtëpi punimet e fëmijëve me shënime për to, fjalët e fëmijëve ose informacione të tjera që shoqërojnë diçka?

22 Berger, E. (2000). *Parents as partners in education*. NJ: Merrill Publishing Company





KOMUNIKIMI EFEKTIV PRIND – MËSUESE: KËSHILLA PRAKTIKE

Si të komunikosh me mësuesen e fëmijës tënd? Diskutimi i problemeve

Kur lindin probleme të ndryshme si kafshimi, këshilla më e mirë për prindërit dhe mësuesen është që të ulen dhe të diskutojnë çështjen së bashku. Nëse fëmija ka problem sjellore serioze mund të flitet dhe me mjekun, i cili mund të njoh më mirë fëmijën dhe mbase e referon në një psikolog.

Nëse fëmija ankohet për mësuesen e vetë është mirë që prindi të përpiqet të kuptojë vërtetësinë dhe specifikat e ankesave. Shpeshherë, fëmijët e vegjël mund të ankohen nëse mësuesja i dënon për diçka (si p.sh. pushim, time - out) ose nëse nuk i jepet një detyrë/rol i preferuar në /klasë, si p.sh. të jetë i pari në rresht. Në një rast të tillë mirë është që të mbështetet mësuesja dhe t'i shpjegohen fëmijës rregullat dhe radha.

Për të vendosur nëse duhet të diskutohet një problem me mësuesen, është e rëndësishme të mos mbivlerësohet perspektiva e fëmijës. Nëse, p.sh., fëmija ankohet se “asnjë nuk luan me mua” ose se “Mërzitem në kopsht” mund të lini të kalojë pak kohë para se të diskutohet me mësuesen, nëse nuk duk duket diçka serioze.

Pëlqimet dhe mospëlqimet e fëmijëve të vegjël ndryshojnë shpesh dhe sapo mësojnë të ndërveprojnë me fëmijë të tjerë të moshës së tyre. Gjithashtu, një sërë faktorësh të tjerë, si p.sh., nëse janë të sëmurë, të uritur ose të lodhur, mund të ndikojnë ndërveprimet e përditshme në IP. Megjithatë, nëse fëmija vazhdon të ankohet, sillet ndryshe se zakonisht, duket i palumtur etj. atëherë mund të flitet me mësuesen.

Nëse prindërit kanë shqetësime për stilin e mësueses ose për performancën e saj mund të flasin fillimisht me atë. Nëse nuk zgjidhen këto shqetësime dhe prindërit vazhdojnë të jenë të pakënaqur, më pas duhet të shkojnë tek drejtuesi i IP. Është më mirë që të përpiqen të zgjidhin problemet e mundshme se sat ë ndryshojnë IP në mes të vitit, përveçse kur të jetë absolutisht e nevojshme. Fëmijët që shkojnë në një IP të ri do priren që të mendojnë se sa herë që ka një problem mund të zgjidhet nëse ndryshohet mësuesja apo IP. Është më mirë që t'i tregohet fëmijëve se si mund të zgjidhen problemet sesa t'i shmangni ato.

Ndërtimi i një marrëdhënieje

Është e rëndësishme që prindërit të kenë një marrëdhënie të mirë me mësuesen e fëmijës suaj, si për prindërit dhe mësuesen ashtu





dhe për fëmijën. Prindërit mund të takohen me mësuesen duke pasur një mendje të hapur dhe të qartë, të bëjnë pyetje të drejtpërdrejta në mënyrë që të mundën të jenë pjesë e përvojave të jetës së fëmijës në IP dhe të jenë krenarë për arritjet e tij/saj.

Prindërit duhet të mbajnë mend të ndajnë krenarinë edhe me mësuesen si dhe me drejtuesen e IP (“Fëmija im e pëlqen shumë tregimin e historive”). Kjo përjasje jo vetëm që e bën mësuesen që të ndihet e vlerësuar, por krijon një kuadër pozitiv që e bën më të lehtë për mësueset të marrin çdo koment negative në një mënyrë konstruktive.

Prindërit mund të mendojnë për veten e tyre dhe mësuesen si një ekip, qëllimi i përbashkët i së cilit është që të bëjnë përvojën e fëmijës në kopsht sa më të këndshme dhe produktive.

Të gjithë fëmijët e vegjël kanë nevojë për pak ndihmë për të bërë tranzicionin nga fëmijë i vogël në fëmijë i kopshtit/çerdhes, dhe sigurisht që do të ankohen në këtë proces. Mbase fëmija i vogël papritmas nuk do të ketë qejf që të shkojë në kopsht. Ose mbase fëmija juaj “llafazan” mund të heshtë fare sa futet në klasë dhe të dojë pak kohë për t’u “ngrohur” sat ë kthehet në shtëpi. Atëherë ky moment mund të diskutohet me mësuesen. Është e rëndësishme të dihet se çfarë do thuhet në mnëyrë që biseda të jetë një mission diplomatic i suksesshëm, që do të zbusë të gjithë problemet e kopshtit. Disa këshilla për prindërit janë:

- **Dini kur të shkruani.** Po, koha ballë për ballë është mënyra e preferuar e komunikimit, por jot ë gjitha çështjet kanë nevojë për diskutim me mësuesen. Disa prindër mund të çojnë një shënim, ose në disa raste një e – mail për çështje me pak të rëndësishme, siç është rasti kur fëmija mund të ketë pak frikë nga në gjë në klasë. Nga ana tjetër, nëse fëmija ka frikë të përdorë tualetin e IP është një çështje që ka nevojë për një diskutim urgjentisht.
- **Koha e duhur për të folur saktë.** A nuk do të ishte mirë nëse një mësuese të linte çdo gjë që ishte duke bërë për të folur me ju kur e merrni/çoni fëmijën nga kopshti/çerdhja? Por, nuk mundet: duhet të kujdeset për të gjithë klasën dhe fëmijët e tjerë. Kështu që, nëse është diçka e rëndësishme merreni në telefon dhe lini një takim (ose prisni për takimin e radhës me prindërit). Thjesht jepini disa informacione mësueses për çështjen që doni të diskutoni në mënyrë që të jetë gati për t’iu përgjigjur pyetjeve tuaja kur do të keni kohën për të folur.
- **Përdorni tonin e duhur.** Kur uleni me mësuesen për të diskutuar një problem për IP mbani mend rregullin: përpara fjalët e mira dhe pastaj të tjerat. Fillojeni me diçka pozitive për përvojën e fëmijës suaj para se të sillni në pah shqetësimet tuaja.





- **Kërkoji i perspektivën e vetë.** Ndonjëherë doni të jeni si një fluturë në murin e klasës që është fëmija juaj (ose të keni akses në një online video gjatë kohës që është në IP). Gjëja tjetër më e mirë është që jut ë merrni perspektivën e mësueses. Kështu që në vend që të bazoheni vetëm në vëzhgimet tuaja (Djali im mërztitet në kopsht, nuk besoj se nxitet aq sa duhet) kërkojini perspektivën e saj (Kam vënë re se djali im nuk është shumë i lumtur kur vjen në IP.A silllet ndryshe këtu?)
- **Shkëmbeni njohuritë.** Mësueset zakonisht nuk janë shumë të lumtura kur një nënë/baba përpiket të kontrollojë klasën e tyre (ato kanë shumë fëmijë në kujdesin e tyre ndërsa ju keni vetëm një), megjithatë ato vlerësojnë perspektivën e prindit. Prandaj sigurohuni që të ndani vëzhgimet tuaja, të cilat mendoni se mund të ndihmojnë mësuesen në zgjidhjen e një problem. Nga ana tjetër, mos harroni ta dëgjoni për atë që ka vënë re tek fëmija juaj, në mjedisin e ri të IP mund të zbulojë anët e fëmijës për të cilat prindërit nuk janë të ndërgjegjshëm ose s'i kanë parë asnjëherë. Mbani mend se një punë e mirë në skuadër dhe komunikimi efektiv është çelësi i një IP të suksesshëm.
- **Vulosni marrëveshjen.** Ekipet e mira varen nga planifikimi i mirë i lojës. Në fund të diskutimit, ju dhe mësuesja duhet të jeni në të njëjtën linjë me një strategji për të zgjidhur problemin dhe për të bërë klasën e fëmijë suaj sa më productive dhe të lumtur. Do të dini se si të menaxhoni më mirë fëmijën tuaj në shtëpi dhe ajo do të di sesi ta bëjë të njëjtën gjë në klasë. Gjithashtu, mund të diskutoni për tu ritakuar ose për të diskutuar përsëri për ecurinë e fëmijës suaj.
- **Jini pozitivë dhe të sjellshëm.** Shume mësuese janë të mbingarkuara dhe të nënvlerësuara. Duke folur në një mënyrë pozitive hap linjat e komunikimit, në mënyrë që të ndihmoni fëmijën tuaj që të ketë sukses në shkollë. Hapeni komunikimin me fjali si: “A mund të flasim për.....?” Shmangni kritikën dhe fajësimin e mësueses me komente si “Duhet të kishe.....” ose “E ke gabim....”. Bëni kërkesa të suksesshme, si “A mund të na çoni informacion në lidhje me...”. Shmangni urdhërat ndaj mësueses si “Duhet të..” ose “Ju duhet të..” Përdorni fjalë të mira sesa luftarake. Për shembull, “Ju lutem, a mund të.....” dhe “Faleminderit për atë që bëtë.....”. Duhet një rrugë e gjatë për të ndërtuar një marrëdhënie të mirë.
- **Pranoni ndryshimet.** Ndonjëherë vërtetë një mësuese ose mësues ju “ngjit” shumë, por ka dhe raste të tjera që duket si luftë për të mbajtur të hapura kanalet e komunikimit.
- **Dëgjojeni mësuesen dhe përpiquni të kuptoni se kush është.**





- **Dëgjoni se çfarë ka për të bërë mësuesja në lidhje me pritshmëritë që ka**, për klasën dhe për fëmijën.
- **Mos argumentoni apo kritikoni** mësuesen në sy të fëmijës.
- **Mos çoni mesazhe** apo të merrni në telefon kur jeni të inatosur.
- Përpiquni që të zgjidhni gjërat me mësuesen **përpara se të shkoni te drejtoresha**.
- Nëse keni konflikte me mësuesen jini të qetë. Dëgjoni, jini pozitivë dhe diskutojini gjërat.

Jini një partner me mësuesen për të mbështetur të mësuarin e fëmijës suaj. 30 vite kërkimi tregojnë se fëmijët shkojnë më mirë në IP nëse prindërit e tyre janë të përfshirë. Disa nga gjërat më të rëndësishme që mund të bëni janë:

- Ndhimoni me detyrat e shtëpisë sipas nevojës dhe nëse është e përshtatshme.
- Ndhimoheni fëmijën tuaj për të mësuar aftësi dhe shprehi për menaxhimin e kohës dhe për të qenë i përqendruar te detyra.
- Pyetini mësueset për sqarime për detyrat nëse është e nevojshme.
- Bisedoni me fëmijën për kohën e kaluar në IP.
- Pyetini mësueset se çfarë mund të bëni për të ndihmuar fëmijën tuaj në shtëpi.

Në të njëjtën kohë, me rritjen e fëmijëve tuaj, mësueset presin që ata të kenë pak më shumë përgjegjësi dhe të veprojnë në një mënyrë më të pavarur. Edhe fëmija juaj ka mundësi që të kërkojë gjithmonë e më shumë pavarësi. Ndhimojini të fitojnë shprehi të reja ndërsa do vazhdoni të jeni mbështetës.

Pyetini ato se çfarë mund të bëni të ndihmoni. Nëse ka diçka që mund të bëni për të ndihmuar mësuesen e fëmijës suaj, ofrohuni si vullnetar. Jepini informacion në lidhje me atë që mund të bëni dhe si mund t'ju kontaktojnë.

- Jepini mësueses numrin tuaj të telefonit dhe e – mailin tuaj.
- Kërkojini nëse mund të ndihmoni me aktivitetet në klasë, me aktivitete jashtë kopshtit ose me diçka në shtëpi.

Mbajini të hapura gjithë vitin kanalet e komunikimit. Çojini një letër falënderimi mësueses së fëmijës kur diçka shkon mirë dhe thojani dhe drejtuesit.





USHTRIM



NDËRTIMI I MARRËDHËNIEVE

Qëllimet

- Ndërgjegjësimi për llojet e ndryshme të komunikimit që përdoren aktualisht
- Nxitja e përdorimit të metodave pjesëmarrëse

Koha

15 minuta

Metoda

Punë individuale dhe diskutim në grup

Hapat

- Shkruani në një letër fjalët: informim dhe lajmërim, konsultime dhe ndërtim i skuadrës/trajnim;
- Listoni anash çdo fjale aktivitetet komunikuese që realizoni që i përkasin asaj kategorie;
- Si mund të rriten aktivitetet në dy kategoritë e fundit nga ana juaj?





USHTRIM



DISKUTIMI I PROBLEMEVE

Qëllimet

- Ndërgjegjësimi për mënyrat e ndryshme për të komunikuar me mësuesen
- Nxitja e përdorimit të metodave të komunikimit efektiv

Koha

30 minuta

Metoda

Luajtje rolesh dhe diskutim në grup

Hapat

1. Pjesëmarrësit ndahen në grupe prej 2 individësh, ku do të marrin rolet mësueses dhe prindit
2. Çiftet duhet të vendosin për diskutimin e një problem që ka pasur fëmija në kopsht mes tyre.
3. Pjesëmarrësit do vendosin për mënyrën e komunikimit (dydrejtimshë) dhe më pas do luajnë rolet e tyre përpara grupit.
4. Diskutohet në grup për atë që shkoi mirë dhe se çfarë mund të përmirësohet.





REFERENCAT

- Fëmijëria e hershme: 5 të parat janë më të mbarat” e marrë nga <http://WWW.prvite5.mk/zhvillimi-i-hershem-i-femijes.nspj> e aksesuar në Shtator 2014
- Damovska, L., Shehu, F., Janeva, N., Palçevska, S. dhe Panova, L.S. (2009). *Zhvillim i hershëm i fëmijëve: Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijëve në moshë prej 0-6 vjeç*. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Maqedoni.
- Organizata e Kombeve të Bashkuara (1989). Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.
- Karaj, Dh. (2005). *Psikologjia e Zhvillimit të Fëmijës*. Progress:Tiranë
- Save the Children in Albania (2010). *Një shkollë për të gjithë*.
- French, G. (2007). *Children’s Early Learning and Development*. National Council for Curriculum and Assessment.
- McCloskey, M. (2007). The whole child. E marrë nga <http://www.ascd.org/publications/newsletters/policy-priorities/fall07/num51/full/The-Whole-Child.aspx> e aksesuar në Shtator 2014
- Kochhar – Bryant, C.A. dhe Heishman, A. (2010). *Effective collaboration for educating the Whole child*. Sage publications
- Neuman, S. (2009). *Changing the Odds for Children at Risk:Seven Essential Principles of Educational Programs That Break the Cycle of Poverty*. Economic Policy Institute and Teachers College; Reprint edition
- Brett, A., Smith, M., Price, E., & Huitt, w. (2003). *Development in the affective domain*. (Unpublished manuscript). Valdosta, GA:Valdosta State University.
- “Developmentally appropriate practice” (2009). E marrë nga <http://www.naeyc.org/DAP> e aksesuar në Shtator, 2014
- Butcher, L.M. dhe Plomin, R. (2008). The Nature of Nurture:A Genomewide Association Scan for Family Chaos, *Behavioral Genetics* 38(4): 361–371.
- Walker, D. (2005). *What Every Teacher Should Know About Diverse Learners : training manual*. Tileston, Thousand Oaks, CA: Corëin Press.
- Underwood, K. (2013). *Everyone is welcome: inclusive early childhood education and care*. Queen’s printer for Ontario.
- Rosenbaum, P. & Gorter, J.W. (2011). The ‘F-words’ in childhood disability: I swear this is how we should think! *Child: care, health, and development*, 38 (4), 457-463





- Walsh, K.B., Kiranxhiska, S. dhe Lazarevski Gjorgjieva, T. (2009). Krijimi i mjedisit për të nxenit për shekullin XXI. Projekti për arsimin fillor. Libri Universitar: Shkup.
- Petrovic, M. (2009). Literature review: Family – school partnership models. E marrë nga <http://www.see-educoop.net/aeiq/documents/v02%20The%20effects%20of%20parent%20involvement%20in%20schools.pdf> e aksesuar në Shtator 2014
- Berger, E. (2000). *Parents as partners in education*. NJ: Merrill Publishing Company
- Galinsky, E. (1989). From our president. A parent/teacher study: Interesting results. *Young Children*, 45(1): 2-3.
- Klein, S. dhe Marian Miller, M. In Support of Family-Teacher Partnerships. E marrë nga http://www.earlychildhoodnews.com/earlychildhood/article_vie.aspx?ArticleID=359 e aksesuar në Shtator 2014
- Texas Education Agency (2011). *Involvement: Schools, parents and you: a training manual for parent involvement*.
- “Parents helping parents: Building bright future for children with special needs” (2007). Parent/Professional Collaboration e marrë nga <http://www.php.com/professionals/story6> e aksesuar në Shtator 2014
- National Center for Family-Centered Care (1990). *What is family-centered care?* (brochure). Bethesda, MD: Association for the Care of Children’s Health.
- Texas Education Agency (2006). *Parent Involvement in Every School: a training manual*.
- Murray, C., O’Doherty, A., (2001). *Respecting Diversity in Early Childhood Care, Education and Training*. Dublin: Pavee Point.
- Cate, D., Diefendorf, M., Mçullough, K., Peters, M. dhe Whaley, K. (2010). *Quality Indicators of Inclusive Early Childhood Programs/Practices: A Compilation of Selected Resources*. National Early Childhood Technical Assistance Center, University of North Carolina at Chapel Hill.
- Fabbi, C. (2014). Guidelines for ECDC in Albania. Save the Children.
- Elkind, D. (2001). *The hurried child. Growing up too fast too soon*. Perseus Publishing.
- “Institucionet arsimore” (2014). E marrë nga [http:// data.planetar.edu.al](http://data.planetar.edu.al) e aksesuar në Shtator 2014
- Rosemon, J. (2014). Living with children: Even in pre-school parents want a ‘Trophy Child’. E marrë nga <http://www.gastongazette.com/lifestyles/family/living-with-children-even-in-pre-school-parents-want-a-trophy-child-1.405463> e aksesuar në Tetor 2014
- National Training Institute for Child Care Health (2010). *Relationships, the heart of development and learning*. U.S. Department of Health and Human Services



SHTOJCAT

SHEMBULL I PROGRAMIT PARASHKOLLOR PËR MOSHËN 4-5 VJEÇARE

1. Zhvillimi gjuhësor

Linjat	Objektivat	Aktivitetet/Koncepte
Gjuhë për komunikim	Komunikon në mënyrë të kuptueshme me moshatarët · Pyet pse ndodhin disa gjëra duke shfaqur kureshtje dhe habi (<i>Shembull: Ku shkoi bora?..</i>) · Merr pjesë në biseda dhe dëgjon ngjarje apo histori.	Diskutim, histori, folës/dëgjues
Gjuhë për të menduar	Përdor të folurit në bisedë · Përdor të folurit kur arrin të lidhë një ide të tijën · Përdor bisedën për të imagjinuar dhe përvojat e së ardhmes	Të folurit, të menduarit, përvojë jetësore personale, kujtesa
Lidhja e tingujve me shkronjat	Përdor qartë rimën në disa fjalë të thjeshta. · Thotë qartë të gjitha tingujt e alfabetit · Tregon disa shkronja që ai i njeh · Identifikon me gisht tek fjalët që kanë shkronjë të njëjtë (<i>Shembull: buka; byreku; brumi, etj</i>)	Rimë, tingull, shkronjë, fjalë
Të lexuarit	Mban një material të shkruar në pozicionin e të lexuarit · Identifikon disa nga shkronjat e mëdha në mënyrë globale në një material të shkruar · Riprodhon me zë një tekst Shpjegon vizatimet e tij	Material i shkruar, tingull, vizatim, shkrim
Të shkruarit	Shkruan emrin e tij me shkronja kapitale · Përdor ngjyrat, lapsin, në të shkruar · Identifikon materialet që përdoren për të shkruar	Shkrimi i emrit (4-5) dhe mjetet e të shkruarit





2. Zhvillimi matematikor

Linjat	Objektivat	Aktivitetet/Koncepte
Numri	(Shembull 4-5 vjec) Kuptimi i numrit natyror deri në 10; Koncepti i numrit rreshtor; Vargu numerik; Leximi dhe shkrimi i numrave deri në 10; Krahasimi dhe rradhitja e numrave; Mbledhja e numrave deri në 6; Zbritja brenda numrit 6;	Kuptimi i numrit natyror deri në 10; Koncepti i numrit rreshtor; Vargu numerik; Leximi dhe shkrimi i numrave deri në 10; Krahasimi dhe rradhitja e numrave; Mbledhja e numrave deri në 6; Zbritja brenda numrit 6;
Gjeometria dhe orientimi në hapësirë	Të emërtojë figurat gjeometrike dydimensionale: katrori; trekëndori; rrethori	Figurat gjeometrike dydimensionale: katrori; trekëndori; rrethori; drejtkëndori; Orientimi për vendndodhjen e objekteve në hapësirë, duke përdorur termat: para – pas; poshtë – lart; mbi – nën; etj.
Matja dhe modele	Të renditë sendet dhe objektet sipas gjatësisë; Të renditë fjalët që tregojnë kohën sipas rrjedhës së saj: mëngjes; drekë; mbasdite; mbrëmje; natë.	Mënyra të thjeshta të matjes së gjatësisë; Përdorimi i terminologjisë: më i gjatë se; më i shkurtër se. Klasifikimi sipas gjatësisë dhe lartësisë. Renditja sipas gjatësisë, dhe lartësisë. Përdorimi i terminologjisë: më i rëndë se; më i lehtë se...Përdorimi i kalendarit Dita; java; muaji;viti dhe stinët. Fjalët që tregojnë kohë: në mëngjes; në drekë etj.
Marrëdhënie dhe funksione	Sipas një ose më shumë cilësive të përbashkëta zbuluar rregullin në modelin e dhënë, sipas formës, ngjyrës, madhësisë.	Modelime sipas një rregulli të caktuar. Krahasimi i modeleve të ndryshme. Klasifikimi i sendeve, 8 elementëve të një grupi tij , zbuluar rregullin në modelin e dhënë, sipas formës, ngjyrës, madhësisë. Të klasifikojë grupe sendesh sipas një cilësie të përbashkët. Sipas një ose më shumë cilësive të përbashkëta sipas një ose më shumë cilësive të përbashkëta





3. Zhvillimi Shkencor

Linjat	Objektivat	Aktivitetet/koncepte
Investigimi Shkencor	Shqisat kryesore · Organet e shqisave · Ndjesitë	Shqisat kryesore · Organet e shqisave · Ndjesitë
Forca, lëvizja dhe energjia	Fëmijët do të vëzhgojnë magnetet dhe dukurinë që ndodh kur ato bashkëveprojnë me materiale të tjerë	Manjetizim / jomanjetizim · Metal / jometal
Materialet	Fëmija do të vëzhgojë që objektet mund të përshkruhen në bazë të karakteristikave të tyre fizike. (psh uji)	Ngjyrat bazë · Figurat (rreth, trekëndësh, katror) · Masa (i madh, i vogël, e hollë, e trashë, e gjatë, e shkurtër)
Proceset jetësore	Fëmija do të investigojë dhe të kuptojë nevojat bazë dhe proceset jetësore të njerëzve.	Të ngjashëm · Identifikimi nëpërmjet emrit
Ndryshimet dhe cikli jetësor,	Stinët · Muajt e vitit · Ditët e javës · Vëzhgimi i motit (ngrohtë, ftohtë, shi, diell) · Ndryshimet mund të njihen, shikohen dhe mund të maten (ngadalë, shpejt).	Stinët · Muajt e vitit · Ditët e javës · Vëzhgimi i motit (ngrohtë, ftohtë, shi, diell) · Ndryshimet mund të njihen, shikohen dhe mund të maten (ngadalë, shpejt).
Burime	Fëmija do të vëzhgojë dhe të kuptojë që materialet mund të ripërdoren, riciklohen dhe të ruhen.	Identifikim materialesh · Përshkrimi i materialeve · Mbeturinat e riciklueshme





4. Zhvillimi social dhe personal

Linjat	Objektivat	Aktivitetet/koncepte
Shoqërimi dhe kujdesi	Rregulla · qëndrim · bashkëpunim · drejtim	Rregulla · qëndrim · bashkëpunim · drejtim
Vetësiguria dhe respekti për veten	Të treguarit kujdes dhe Shqetësim për veten · të folurit lirshëm për Shtëpinë dhe Komunitetin.	Vetësiguri · respekt · shtëpi · shkollë
Krijimi i marrdhënieve	Krijimi i marrëdhënie me Anëtarët e grupit · të përshtaturit e sjelljes Në situata të ndryshme Sociale.	Marrëdhënie · përshtatje
Sjellja dhe vetkontrolli	Të treguarit kujdes dhe Shqetësim për të tjerët · të përshtaturin e të sjellurit sipas situatës	Vetëkontroll · sjellje · shqetësim
Vetëkujdesi	Të ndërmarrurit e Iniciativave	Iniciativë · vetëkujdes
Ndjenja e komunitetit	Shfaqja e fortë e Ndjenjës së komunitetit Si një anëtar i Komuniteteve të Ndryshme (për shembull Në familje, në shkollë)	Komunitet

5. Edukimi artistik

Linjat	Objektivat	Aktivitete/koncepte
Drama	Të luajë në një pjesë teatrale. · Të motivohet për të qenë sa më skenik. · Të përshtatë sipas rolit veshjet ose maskat, skenën e improvizuar. etj	Pjesë e thjeshtë teatrale Personazhe Kostume Maska
Muzikë	Të dallojë tingujt nga mjedisi dhe muzika. · Të dallojë tingujt nga zhurmat. · Të zhvillojë ndjenjën ritmike në muzikë. · Të imitojë me zë tingujt e veglave muzikore.	Tinguj natyralë dhe tinguj muzikorë Zhurmat Ritmi Shpejt – ngadalë Zëri (folës dhe vokal) Kënga Dëgjimi Imitimi





Arti figurativ	Të përdorë <i>mjete dhe materiale</i> të ndryshme. · Të vizatojë <i>llojet e vijave</i> : të shkurtra, horizontale, të gjata, të valëzuara. · Të përcaktojë <i>ngjyrat bazë</i> në mjedisin që e rrethon: e kuqe, e verdhë, jeshile. · Të përcaktojë <i>figura të thjeshta gjeometrike</i> . · Të punojë me ndihmën e <i>shabllonit</i> . · Të punojë me <i>plastelinë dhe argjil</i> . · Të vlerësojë punët e vet dhe të tjerëve.	Mjete dhe materiale · Vijat · Ngjyrat bazë · Format · Modelet, Shabllo
Vallëzimi	Të koordinojë <i>melodinë me lëvizjet e trupit</i> . · Të vallëzojë duke zbatuar dinamikën: <i>shpejtë ngadalë</i> . · Të kërcejë duke mbajtur ritmin (nëpërmjet goditjeve me shuplakave). · Të imitojë lëvizje të thjeshta të kërcimit: popullore etj..	Trupi · Hapësira · Lëvizjet · Dinamika (shpejt, ngadalë) · Figura vallëzuese

6. Edukimi fizik dhe shëndetësor

Linjat	Objektivat	Aktivitete/koncepte
Lëvizja	Të kryejë lloje të ndryshme veprimesh si: <i>vrapim, kërcim, rrëshqitje, zgjatje, rrotullim etj.</i> · Të orientohet në hapësirë kur luan.	Ecje, Lëvizje (vrapim, kërcim, rrotullim, rrëshqitje, zgjatje, përkulje) Kohë
Orientimi në hapësirë	Të ulet, të ngrihet dhe balancohet me pjesët e ndryshme të trupit. · Të vetëkontrollohet në një pozicion fikse.	Hapësirë Natyre Përshtatje Lojë Drejtim AfërLarg, Lartposhtë
Shëndeti dhe trupi	Të zbulojë vetveten. · Të bashkëpunojë me shokët në ndarjen e detyrave. · Të kryejë praktikat higjienosanitare gjatë ngrënies dhe fjetjes	Kolonë Skuadër I gjatëi shkurtër I hollë – i trashë
Përdorimi i pajisjeve	Të rrisë kontrollin gjatë përdorimit të pajisjeve dhe konstruksioneve.	Objekt Ndërtim Lartësi
Përdorimi i mjeteve dhe materialeve	Të krijojë modele me dy tri pjesë. · Të presë dhe të ngjisë modele të thjeshta. · Të mirëmbajë mjetet dhe materialet që ka në përdorim.	Prerje Mirëmbajtje





Qendra Burimore për Mirëqenien
e Fëmijëve dhe Familjes

Qendra Burimore për Mirëqenien e
Fëmijëve dhe Familjes

Rr. "Niko Avrami", P.9, SH.3, AP.40,
Tirana, Albania
Email: rcwcf@yahoo.co.uk



Save the Children

Rr. "Komuna e Parisit", Lagjia 8, Pallatet 1
Maji, Vila "Lami"; P.O. Box 8185,
Tiranë - Albania
Tel: +355 4 2261840 / 2261929 / 2266227
Fax: +355 4 2263 428
Email: info.albania@savethechildren.org,
Web Page: albania.savethechildren.net
Facebook: savethechildrenal
Twitter: SaveChildrenAlb